

LIGJ
PER MBIKEQYRJE INSPEKTUESE

I. Dispozita te pergjithshme

Neni
1

Lenda e ligjit

Me kete ligj rregullohen parimet themelore te mbikeqyrjes inspektuese, statusi, kompetencat dhe puna e Keshillit inspektues, organizimi dhe udheheqja me sherbimet inspektuese, percjellja, kontrolli dhe koordinimi i punes se sherbimeve inspektuese, statusi dhe punesimi i inspektorit, licenca per inspektor, te drejtat dhe obligimet e inspektorit (sistemi i kompensimeve per roga te inspektoreve, sistemi per persosje profesionale dhe trajnim te inspektoreve), kontributi i inspektorit, te drejta dhe obligime te subjekteve te mbikeqyrjes inspektuese gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, procedura e kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, veprimet e vecanta ne proceduren inspektuese, marredheniet e sherbimeve inspektuese dhe organeve kompetente, si dhe zbatimi i ligjit.

Neni
2

Zbatimi i ligjit

(1) Dispozitat e ketij ligji, qe kane te bejne me proceduren per kryerje te mbikeqyrjes inspektuese, aplikohen per sherbimet inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive ose njesi organizative, ne kuader te organeve te administrates shteterore, komunave, komunave ne Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit.

(2) Dispozitat e ketij ligji, qe kane te bejne me obligimet e sherbimeve inspektuese ndaj Keshillit inspektues, vlejne per sherbimet inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive ose si njesi organizative ne kuader te organeve te administrates shteterore.

(3) Dispozitat e ketij ligji, qe kane te bejne me proceduren per kryerje te mbikeqyrjes inspektuese, aplikohen per sherbimet inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive ose njesi organizative, ne kuader te organeve te administrates shteterore, komunave, komunave ne Qytetin e Shkupit dhe Qytetit te Shkupit.

(4) Dispozitat nga paragrafet (1), (2) dhe (3) nuk zbatohen ne Ministrine e Financave, duke i perfshire Drejtorine per te Ardhura Publike dhe Drejtorine Doganore, Ministrine e Mbrojtjes, Drejtorine per Siguri te Informatave te Klasifikuara dhe Ministrine e Puneve te Brendshme.

**Neni
3**

Kuptimi i shprehjeve te perdorura ne kete ligj

Shprehje te caktuara qe perdoren ne kete ligj e kane kete kuptim:

- 1) Mbikeqyrja inspektuese eshte mbikeqyrje mbi aplikimin e ligjeve dhe dispozitave tjera dhe akteve te pergjithshme ne punen e subjekteve te mbikeqyrjes;
- 2) Subjekt i mbikeqyrjes inspektuese eshte person juridik dhe fizik i percaktuar me ligjet ne te cilat eshte parapare kryerja e mbikeqyrjes inspektuese;
- 3) Inspektor eshte person zyrtar me autorizime, pergjegjesi, te drejta dhe obligime te percaktuara me ligj, i cili kryen mbikeqyrje inspektuese;
- 4) Procedure inspektuese eshte lloj i procedures, e rregulluar me kete ligj, me Ligjin per proceduren e pergjithshme administrative ose me ligj tjeter te vecante;
- 5) Akte inspektuese dhe veprime jane te gjitha aktet dhe veprimet, te cilat inspektorët i miratojne dhe ndermarrin ne proceduren inspektuese;
- 6) Masa inspektuese jane masa te parapara me kete ligj dhe me tjeter ligj, te cilat i ndermarrin inspektorët gjate mbikeqyrjes inspektuese per shkak te menjanimit te parregullsive dhe mangesive te percaktuara;
- 7) Verejtje eshte mase inspektuese me te cilen subjekti i mbikeqyrjes fillimisht obligohet t'i menjanoje parregullsire dhe mangesire e konstatuara ne afat te caktuar dhe
- 8) Vleresim i rrezikut eshte proces i analizes, menaxhimit dhe informimit per rrezikun nga mosharmonizimi i punes se subjektit te mbikeqyrjes, me dispozitat nga fusha perkatese.

**Neni
4**

Perdorimi i gjuheve dhe alfabeteve

Dispozitat nga Ligji per perdorimin e gjuheve ne menyre perkatese zbatohen gjate mbikeqyrjes inspektuese.

II. Parime themelore te mbikeqyrjes inspektuese

**Neni
5**

Parimi i ligjshmerise

Ne kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese, inspektori eshte i obliguar te veproje ne pajtim me Kushtetuten, ligjet, marreveshjet nderkombetare te ratifikuara ne pajtim me Kushtetuten dhe dispozita tjera te miratuara ne baze te ligjit.

Neni

6

Parimi i mbrojtjes se interesit publik

Gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, inspektori siguron mbrojtje te interesit publik.

Neni

7

Parimi i barazise, paanshmerise dhe objektivitetit

Inspektori ne kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese siguron barazi, paanshmeri dhe objektivitete ndaj subjekteve te mbikeqyrjes inspektuese.

Neni

8

Parimi i pergjegjesise

Inspektori eshte i obliguar per kryerje profesionale dhe te ndergjegjshme te mbikeqyrjes inspektuese dhe per demin e shkaktuar me veprim joligjor ose refuzim joligjor te ndermerr veprim perkates.

Neni

9

Parimi i te vertetes materiale

Inspektori, me detyre zyrtare, e konstaton gjendjen faktike dhe prezanton prova ne proceduren e mbikeqyrjes inspektuese.

Neni

10

Parimi i degjimit te subjekteve te mbikeqyrjes inspektuese

Para ndermarrjes se masave inspektuese per menjanimin e parregullsive dhe mungesave, te konstatuara tek subjektet e mbikeqyrjes inspektuese, inspektori eshte i obliguar t'u jep mundesi subjekteve te mbikeqyrjes inspektuese te prononcohen per faktet dhe rrethanat qe do te konstatohen gjate mbikeqyrjes inspektuese.

Neni 1

1

Parimi i mevetesise

Inspektori ne suazat e autorizimeve dhe kompetencave te tij, te percaktuara me kete dhe ligj tjeter, eshte i pavarur dhe autonom ne kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese dhe ne ndermarrjen e masave inspektuese te percaktuara me ligj.

Neni 1

2

Parimi i publicitetit

(1) Mbikeqyrja inspektuese eshte publike.

(2) Sherbimet inspektuese, nepermjet ueb faqeve te tyre dhe ueb faqes se Keshillit Inspektues, rregullisht publikojne informata te rendesishme per publikun, per veprimet e zbatuara dhe per masat e ndermarra inspektuese per arsye te mbrojtjes se jetes dhe shendetit te njerezve ose prones apo per arsye te crregullimeve me te renda te interesit publik.

Neni 1

3

Parimi i proporcionalitetit

(1) Gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, inspektori ndermer masa inspektuese ne pajtim me ligjin, te cilat jane te domosdoshme per menjanimin e parregullsive dhe mungesave te percaktuara, te cilat jane me te volitshme per subjektin e mbikeqyrjes inspektuese, gjate kesaj duke pasur kujdes te mos e pengoje funksionimin efikas te subjektit te mbikeqyrjes inspektuese.

(2) Gjate percaktimit te masave inspektuese dhe afatit per percaktimin e mungesave te percaktuara inspektori udhehiqet nga pesha e mangesise, pasojat e demshme te shkaktuara ndaj interesit publik ose interesit te personave te trete, si dhe kohen qe eshte e nevojshme subjekti i mbikeqyrjes inspektuese t'i menjanoje mungesat e konstatuara.

Neni 1

4

Parimi i parandalimit

Gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, inspektori fillimisht kryen funksion parandalues, nderkaq ndermerr masa inspektuese ateherë kur me funksionin parandalues nuk mund te sigurohet qellimi i mbikeqyrjes inspektuese.

Neni 1

5

Parimi i subsidiaritetit

Ne proceduren inspektuese aplikohen dispozitat nga Ligji per procedure te pergjithshme administrative, nese me kete apo ligj tjeter nuk eshte rregulluar ndryshe.

III. Statusi, kompetenca dhe puna e Keshillit inspektues

Neni 1

6

Statusi i Keshillit inspektues

(1) Keshilli inspektues (ne tekstin e metejme: Keshilli) eshte organ i pavarur i administrates shteterore ne cilesi te personit juridik, me seli ne Qytetin e Shkupit, me te drejta, obligime dhe pergjegjesi te percaktuara me kete ligj.

(2) Me se voni deri me 15 dhjetor te vitit rrjedhes, Keshilli miraton plan vjetor per pune, per vitin e ardhshem.

(3) Keshilli per punen e vet parashtron raport vjetor per informim ne Qeverine e Republikes se Maqedonise se Veriut (ne tekstin e metejme: Qeveria) dhe Kuvendin e Republikes se Maqedonise se Veriut, me se voni deri ne fund te tremujorit te pare te vitit rrjedhes per vitin paraprak.

Neni 1

7

Udheheqja me Keshillin inspektues

(1) Me Keshillin inspektues udheheq kryetari.

(2) Ne rast te mungeses ose pengeses per ardhje ne pune, kryetarin e zevendeson njeri prej anetareve te Keshillit, i autorizuar nga kryetari.

Neni 1

8

Kompetenca te Keshillit inspektues

(1) Keshilli i kryen punet ne vijim:

1) e percjell dhe koordinon punen e sherbimeve inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive dhe njesive organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te organeve tjera te administrates shteterore;

2) kujdeset per aplikimin e standardeve te njohura nderkombetare per mbikeqyrje inspektuese te percaktuara nga organizatat nderkombetare, evropiane dhe rajonale per standardizim, si dhe per standardet dhe dokumentet tjera te standardizimit qe e perbejne standardizimin nacional, si dhe rregullat per praktike pozitive qe i aplikon subjekti i mbikeqyrjes inspektuese;

3) jep pelqim me shkrim per planin vjetor per mbikeqyrje inspektuese te sherbimeve inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive dhe njesive organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te organeve tjera te administrates shteterore;

4) jep mendim per metodologjite per vleresim te rrezikut te miratuara nga ana e sherbimeve inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive dhe njesive organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te organeve tjera te administrates shteterore;

5) jep mendim per raportet gjashtemujore per mbikeqyrje inspektuese te sherbimeve inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive dhe njesive organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te organeve tjera te drejtorise shteterore;

6) jep mendim per propozimet e ligjeve dhe aktet nenligjore nga fusha e mbikeqyrjes inspektuese;

7) sjell udhezime per perpilimin e akteve per organizimin e brendshem dhe sistematizim te sherbimeve inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive dhe njesive organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te organeve tjera te administertes shteterore, ne baze te te cilave Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates jep pelqim;

8) perpilon raport vjetor per punen e sherbimeve inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive dhe njesive organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te organeve tjera te administrates shteterore, te cilin e parashton ne Qeveri;

9) leshon urdher per zbatim te mbikeqyrjes inspektuese te vecante dhe te perbashket, te sherbimeve inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive dhe njesive organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te organeve tjera te administrates shteterore;

10) miraton program per trajnim interaktiv per marrje te licences per inspektor;

11) miraton program per provim per licence per inspektor – pjesa e pergjithshme dhe e organizon dhe zbaton pjesen e pergjithshme te provimit per licence per inspektor;

12) e leshon dhe heq licencen per inspektor;

13) zhvillon politika per menaxhim me efektin e inspektoreve dhe e percjell suksesin e punes se tyre;

14) krijon kornize te vetme per zhvillim dhe menaxhim me inspektoret ne sherbimet inspektuese te organizuara si organe ne perberje te ministrive dhe njesive organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te organeve tjera te administrates shteterore;

15) vendos dhe mban sistem per persosje profesionale dhe trajnim te inspektoreve ne sherbimet inspektuese te organizuar si organe ne perberje te ministrive dhe njesive organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te organeve tjera te administrates shteterore;

16) miraton dhe zbaton program vjetor per trajnim gjenerik te inspektoreve ne sherbimet inspektuese te organizuar si organe ne perberje te ministrive dhe njesive organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te organeve tjera te administrates shteterore;

17) miraton plan strategjik, plan vjetor per pune dhe raport vjetor per pune te Keshillit;

18) vendos dhe mban regjistra dhe sistem informativ per menaxhim me mbikeqyrjen inspektuese;

19) vepron per parashtresa te personave fizike dhe juridike, ne lidhje me punen e inspektoreve, sherbimeve inspektuese dhe/ose subjekteve te mbikeqyrjes inspektuese;

20) parashtron propozim per shkarkim te drejtorit te sherbimit inspektues nga neni 26, paragrafi (1), pika 1;

21) parashtron iniciative per percaktim te pergjegjesise disiplinore te inspektorit;

22) zbaton bashkepunim nderkombetar ne fushen e mbikeqyrjes inspektuese dhe

23) pune tjera te percaktuara me ligj.

Neni 1

9

Puna e Keshillit

(1) Keshilli punon dhe vendos ne mbledhje.

(2) Vendimet e Keshillit miratohen me shumice votash nga numri i pergjithshem i anetareve, kurse i nenshkruan kryetari ose anetari i Keshillit te cilin ai do ta autorizojë.

(3) Plani vjetor per pune te Keshillit, raporti vjetor per pune te Keshillit, raporti vjetor per pune te sherbimeve inspektuese dhe programi vjetor per trajnim gjenerik te inspektoreve, publikohen ne ueb faqen e Keshillit.

(4) Keshilli miraton rregullore per pune dhe akte tjera, me te cilat prej se afermi rregullohet menyra e punes dhe zbatimi i kompetencave te tij.

Neni 2

0

Perberja e Keshillit

(1) Keshilli ka kryetar dhe gjashte anetare, te cilet funksionin e kryejne ne menyre profesionale, me mandat prej kater viteve, me te drejte per zgjedhje te serishme.

(2) Anetaret e Keshillit zgjedhen ne fushat ne vijim:

- 1) treg, marredhenie te punes dhe siguri dhe shendet gjate punes;
- 2) mjedis jetesor dhe mbrojtja e shendetit te njerezve;
- 3) ndertimtari, urbanizem, pune komunale dhe transport;
- 4) bujqesi, pylltari, veterinari dhe siguri e ushqimit;
- 5) arsim, shkence dhe kulture dhe
- 6) administrate.

Neni 21

Zgjedhja e kryetarit dhe anetareve te Keshillit

(1) Kryetar i Keshillit mund te zgjidhet personi i cili:

- 1) ka shtetesi te Republikes se Maqedonise se Veriut;
- 2) ne momentin e zgjedhjes me aktgjykim te plotfuqishem gjyqesor nuk i eshte shqiptuar denim me burg ose sanksion per kundervajtje ndalese per kryerje te profesionit, veprimtarise ose detyres;
- 3) ka fituar se paku 240 kredi sipas SETK ose shkallen VII/1 te mbaruar;
- 4) ka se paku gjashte vite pervoje pune ne pozicion pune udheheqes, pas diplomimit;
- 5) posedon nje prej ketyre certifikatave te njohura nderkombetare ose vertetimeve per njohje aktive te gjuhes angleze:
 - TOEFEL IBT – se paku 74 pike,
 - IELTS – se paku 6 pike,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) – se paku niveli B2 (B2),
 - FCE (Cambridge English: First) – te dhene,
 - BULATS – se paku 60 pike ose
 - APTIS – se paku niveli B2 (B2),

6) posedon vertetim per njohje aktive te programeve kompjuterike per pune ne zyre. (2)
Anetar i Keshillit mund te zgjidhet personi i cili:

- 1) ka shtetesi te Republikes se Maqedonise se Veriut;

2) ne momentin e zgjedhjes me aktgjykim te plotfuqishem gjyqesor nuk i eshte shqiptuar denim me burg ose sanksion per kundervajtje ndalese per kryerje te profesionit, veprimtarise ose detyres;

3) ka fituar se paku 240 kredi sipas SETK ose shkallen VII/1 te mbaruar;

4) se paku gjashte vjet pervojave pune pas diplomimit, ne fushen perkatese, per te cilen eshte zgjedhur si anetar;

5) posedon nje prej ketyre certifikatave te njohura nderkombetare ose vertetime per njohje aktive te gjuhes angleze:

- TOEFEL IBT – se paku 74 pike,
- IELTS – se paku 6 pike,
- ILEC (Cambridge English: Legal) – se paku B2 (B2) niveli,
- FCE (Cambridge English: First) – te dhene,
- BULATS – se paku 60 pike ose
- APTIS – se paku niveli B2 (B2)

6) posedon vertetim per njohje aktive te programeve kompjuterike per pune ne zyre.

(3) Kryetarin dhe anetaret e Keshillit, ne baze te konkursit publik i zgjedh dhe i shkarkon Qeveria.

(4) Konkursin publik e shpall Qeveria dhe nuk mund te jete me i shkurter se 15 dite, duke e perfshire diten e shpalljes se te njejt.

(5) Konkursi publik shpallet ne ueb faqen e Qeverise, si dhe ne se paku dy gazeta ditore, nga te cilat nje qe shtypet ne gjuhen qe e flasin se paku 20% te qytetareve te cilet flasin gjuhe zyrtare te ndryshme nga gjuha maqedonase.

(6) Konkursi publik nga paragrafi (3) i ketij neni, shpallet gjashte muaj para skadimit te mandatit te kryetarit dhe anetareve te Keshillit.

(7) Kryetari dhe anetaret e Keshillit nuk mund te jene anetare ne organe dhe trupa qe i zgjedh ose emerom Kuvendi i Republikes se Maqedonise se Veriut ose Qeveria.

Neni 2

2

Shkarkimi i kryetarit dhe anetarit te Keshillit

(1) Kryetari, perkatesisht anetari i Keshillit, mund te shkarkohet para skadimit te mandatit per te cilin eshte zgjedhur, ne keto raste:

1) me kerkese te vet;

2) nese me aktgjykim te plotfuqishem gjyqesor eshte i denuar me denim me burg ose i eshte shqiptuar ndalese per kryerje te profesionit, veprimtarise ose detyres;

3) per shkak te aftesise se humbur afariste per kryerje te funksionit dhe

4) per shkak te shkeljes se dispozitave ose keqperdorimit te funksionit.

(2) Pas shkarkimit te kryetarit ose anetarit te Keshillit, ne rastet nga paragrafi (1) i ketij neni, Qeveria ne afat prej shtate diteve, emerone ushtrues te detyres, deri ne zgjedhjen e kryetarit te ri ose anetarit ne pajtim me dispozitat nga neni 21 i ketij ligji, por jo me gjate se tre muaj.

Neni 23

Kompetenca te kryetarit te Keshillit

Kryetari i Keshillit:

- 1) e koordinon, organizon dhe udheheq punen e Keshillit;
- 2) e perfaqeson dhe prezanton Keshillin;
- 3) ndermerr masa juridike ne emer dhe per llogari te Keshillit;
- 4) sjell dispozita dhe akte tjera per te cilat eshte i autorizuar me ligj;
- 5) sjell akte per organizim dhe sistematizimin e brendshem te vendeve te punes ne sherbimin administrativo-profesional te Keshillit;
- 6) leshon urdher per mbikeqyrje te ndare dhe te perbashket inspektuese;
- 7) perkujdeset dhe e siguron transparencen ne punen e Keshillit;
- 8) konvokon dhe kryeson me mbledhjet e Keshillit;
- 9) parashtroon kerkese ne Keshillin, per parashttrim te iniciatives per ngritje te procedures disiplinore kunder inspektorit;
- 10) ne pajtim me ligj ndermerr edhe masa tjera.

Neni 24

Kompetencat e anetarit te Keshillit

Anetari i Keshillit:

- 1) merr pjese ne punen e mbledhjeve te Keshillit;
- 2) propozim vendime te Keshillit;

3) i shqyrton dokumentet e programit dhe te raportit te sherbimeve inspektuese ne sferen per te cilen eshte zgjedhur;

4) dorezon propozim me shkrim te kryetari i Keshillit, per leshimin e urdhrit per mbikeqyrjen e vecante dhe te perbashket inspektuese;

5) e ndjek dhe e koordinon punen e sherbimeve inspektuese ne sferen per te cilen eshte zgjedhur;

6) i shqyrton dhe propozon mendime per aktet ligjore dhe nenligjore, qe i propozojne organet e sferes perkatese;

7) parashtrohet kerkese te Keshilli, per parashtimin e iniciatives per ngritjen e procedures disiplinore kunder inspektorit;

8) vepron per parashtresa ne sferen per te cilen eshte zgjedhur, te parashtuara nga personat fizike dhe juridike;

9) kryen pune tjera nga fusheveprimi i sferes per te cilen eshte zgjedhur ne pajtim me ligjin.

Neni 2

5

Sherbimi administrativ profesional i Keshillit

(1) Keshilli ka sherbim administrativ profesional, me te cilin udheheq sekretari i pergjithshem ne menyren qe siguron pune ligjore, profesionale, pergjegjese, me kohe dhe ekonomike.

(2) Per te punesuarit ne sherbimin administrativ profesional te Keshillit zbatohen dispozitat e Ligjit per nepunes administrative, Ligjit per te punesuarit ne sektorin publik dhe rregullat e pergjithshme nga sfera e marredhenies se punes.

IV. Organizimi dhe udheheqja me sherbimet inspektuese

Neni

26

Organizimi i sherbimeve inspektuese

(1) Sherbimet inspektuese jane organizuar si:

1) organe ne perberjen e ministrive – inspektorate shteterore per sfera te vecanta;

2) njesi organizative per mbikeqyrjen inspektuese ne perberjen e organeve te administrates shteterore – sektor ose seksion per mbikeqyrje inpektuese;

3) njesi organizative per mbikeqyrje inspektuese ne perberje te komunave, komunave ne Qytetin e Shkupit dhe Qytetit te Shkupit – Sektor ose seksion per mbikeqyrje inspektuese.

(2) Sherbimet inspektuese nga paragrafi (1) pika 1, kane cilesine e personit juridik.

Neni 2

7

Udheheqja me sherbimet inspektuese

(1) Me sherbimet inspektuese nga neni 26, paragrafi (1), pika 1 te ketij ligji, udheheq drejtori (ne tekstin e metejme: drejtori), te cilin ne baze te konkursit publik, e emeron dhe e shkarkon Qeveria.

(2) Konkursi publik nga paragrafi (1) i ketij neni, shpallet gjashte muaj para skadimit te mandatit te drejtorit.

(3) Konkursin publik e shpall Qeveria dhe nuk mund te jete me i shkurter se 15 dite, duke e perfshire diten e shpalljes se tij.

(4) Konkursi publik publikohet ne faqen e internetit te Qeverise, si dhe ne se paku dy gazeta ditore, prej te cilave njera qe botohet ne gjuhen qe e flasin se paku 20% te qytetareve qe flasin ne gjuhe zyrtare te ndryshme nga gjuha maqedonase.

(5) Drejtori funksionin e ushtron ne menyre profesionale, me mandat prej kater vitesh dhe me te drejte edhe te nje zgjedhjeje.

(6) Drejtori per punen e vet pergjigjet para Qeverise.

(7) Me sherbimet inspektuese nga neni 26, paragrafi (1), pikat 2 dhe 3 te ketij ligji, udheheq inspektori i udheheqjes i kategorise B dhe niveli i cili i pergjigjet formes organizative te sherbimit inspektues te percaktuar me ligj (ne tekstin e metejshem: udheheqes i sherbimit inspektues).

(8) Udheheqesi i sherbimit inspektues per punen e vet pergjigjet para funksionarit perkatesisht personit udheheqes te organit perkates perkatesisht kryetarit te komunes, ne kornizat e te cilit punon sherbimi inspektues.

(9) Drejtori dhe udheheqesi i sherbimit inspektues nuk mund te jene anetare ne organet dhe trupat qe i zgjedh ose emeron Kuvendi i Republikes se Maqedonise se Veriut ose Qeveria ose njesia perkatese e veteqeverisjes lokale.

Neni

28

Kushtet e pergjithshme per emerimin e drejtorit

(1) Drejtor mund te emerohet personi i cili:

- 1) ka shtetesi te Republikes se Maqedonise se Veriut;
 - 2) ne momentin e emerimit me aktgjykim te plotfuqishem gjyqesor nuk i eshte shqiptuar denim me burg ose sanksioni i kundervajtjes ndalim per ushtrimin e profesionit, veprimtarise ose detyres;
 - 3) ka fituar se paku 240 kredi sipas SETK-se ose ka mbaruar shkallen VII/1;
 - 4) ka se paku gjashte vjet pervojë pune pas diplomimit, ne sferen perkatese;
 - 5) posedon njerën nga certifikatat njohura nderkombetarisht per njohjen aktive te gjuhes angleze:
 - TOEFEL IBT – se paku 74 pike,
 - IELTS – se paku 6 pike,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) – se paku niveli B2(B2),
 - (FCE) (Cambridge English: First) – te dhene,
 - BULATS – se paku 60 pike ose
 - APTIS – se paku niveli B2 (B2).
 - 6) Posedon vertetim per njohjen aktive te programeve kompjuterike per pune ne zyre;
- (2) Krahas kushteve te pergjithshme nga paragrafi (1) i ketij neni, me ligj mund te percaktohen edhe kushtet e vecanta per emerimin e drejtorit.

Neni 2

9

Shkarkimi i drejtorit

- (1) Drejtori mund te shkarkohet para skadimit te mandatit per te cilin eshte emeruar, ne rastet si vijon:
- 1) me kerkese te tij;
 - 2) me propozim te Keshillit;
 - 3) nese me vendim te plotfuqishem gjyqesor eshte denuar per veper penale me denim me burg ose i eshte shqiptuar denim ndalim i ushtrimit te profesionit, veprimtarise ose detyres;
 - 4) per shkak te humbjes se aftesise per pune per ushtrimin e funksionit dhe/ose
 - 5) per shkak te shkeljes se rregullave ose keqperdorimit te funksionit.
- (2) Pas shkarkimit te drejtorit, ne rastet nga paragrafi (1) i ketij neni, Qeveria ne afat prej shtate ditesh, emeron ushtrues detyre, deri ne zgjedhjen e drejtorit te ri ne pajtim me dispozitat nga neni 28 i ketij ligji, por jo me gjate se tre muaj.

Neni

30

Kompetencat e drejtorit

(1) Drejtori i kryen punet si vijojne:

- 1) e koordino dhe e organizon punën e inspektoratit;
- 2) e prezanton dhe e përfaqëson inspektoratin;
- 3) ndërmer veprime juridike në emër dhe për llogar të inspektoratit;
- 4) siguron kushte për zbatimin efikas të ligjeve dhe rregullave që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese;
- 5) vendos për të drejtat dhe obligimet e të punësuarve në inspektorat;
- 6) siguron kushte për përsosjen profesionale dhe trajnimin e specializuar të inspektorëve;
- 7) miraton akte për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në inspektorat;
- 8) miraton dokumente programore dhe raportuese, duke përfshirë:
 - plan strategjik të inspektoratit;
 - plan vjetor për punën e inspektoratit;
 - program vjetor për trajnimin e specializuar të inspektorëve;
 - raport gjashtë mujor për punën e çdo inspektori;
 - plan mujor për punën e çdo inspektori;
 - dokumente dhe akte tjera të parapara me këtë ligj ose ligj tjetër;
- 9) miraton edhe akte tjera për të cilat është i autorizuar;
- 10) siguron transparencë në punën e inspektoratit;
- 11) punë tjera nga kompetenca e inspektoratit, në pajtim me ligjin.

(2) Drejtori ne mungese te tij ose kur per shkak te semundjes dhe shkaqeve tjera, nuk ka mundesi ta ushtroje funksionin, e zevendeson njeri nga inspektorët udheheqes, i autorizuar nga drejtori.

Neni

31

Kompetencat e udhëheqesit të shërbimit inspektues

(1) Udhehegesi i shërbimit inspektues i kryen punët si vijon:

- 1) e koordinon dhe e organizon punen e sherbimit inspektues;

2) siguron kushte per zbatimin efikas te ligjeve dhe rregullave qe kane te bejne me mbikeqyrjen inspektuese;

3) siguron kushte per persosjen profesionale dhe trajnimin e specializuar te inspektoreve;

4) miraton dokumente te programit dhe raportit, duke perfshire:

- plan strategjik te sherbimit inspektues,
- plan vjetor per punen e sherbimit inspektues,
- program vjetor per trajnimin e specializuar te inspektoreve,
- raport gjashtemujor per punen e cdo inspektori,
- plan mujor per punen e cdo inspektori,
- dokumente dhe akte tjera te parapara me kete ligj ose ligj tjetër;

5) siguron transparence ne punen e sherbimit inspektues;

6) pune tjera nga kompetenca e sherbimit inspektues, ne pajtim me ligjin;

(2) Udheheqesi i sherbimit inspektues ne mungesen e tij ose kur per shkak te semundjes dhe shkaqeve tjera nuk ka mundesi ta kryeje punen, e zevendeson njeri nga inspektoret udheheqes, e nese nuk ka inspektore udheheqes, inspektori i kategorise V, i autorizuar nga personi udheheqes i organit perkates perkatesisht kryetari i komunes, ne kornizat e te cilit punon sherbimi inspektues.

V. Ndjekja e punes se sherbimeve inspektuese

**Neni
32**

Vleresimi i rrezikut

(1) Mbikeqyrja inspektuese bazohet ne vleresimin e rrezikut.

(2) Sipas shkalles, rreziku mund te jete i ulet, i mesem dhe i larte.

(3) Vleresimi i rrezikut behet gjate perpilimit te planit vjetor per punen e sherbimit inspektues. (4) Vleresimi i rrezikut e perfshin analizen, menaxhimin dhe njoftimin per rrezikun dhe zbatohet sipas metodologjise per vleresimin e rrezikut, te cilen e miraton udheheqesi i sherbimit inspektues nga neni 26, paragrafi (1), pikat 1 dhe 2, pas mendimit paraprak te Keshilli t per harmonizimin me aktin nga paragrafi (9) te ketij neni.

(5) Nese nderrohen rrethanat ne baze te te cilave eshte bere vleresimi i rrezikut, sherbimi inspektues do te beje revizionin e vleresimit te rrezikut, i cili do te merret parasysh gjate perpilimit te planeve mujore per punen e sherbimit inspektues.

(6) Vleresimi i rrezikut, behet nepermjet:

1) identifikimit të rrezikut për të mirat e mbrojtura, të drejtat dhe interesat, mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerezve, që mund të ndodhin si pasojë e punës së subjektit të mbikeqyrjes dhe

2) vlerësimit të peshës së pasojave të demshme dhe probabilitetit për ndodhjen e tyre.

(7) Pësia e pasojave të demshme, vlerësohet në baza të:

1) natyrës së pasojave të demshme që del nga lloji i veprimtarisë së subjektit të mbikeqyrjes inspektuese dhe/ose nga karakteristikat e prodhimit që vihet në treg përkatësisht shërbimi i cili jepet nga ana e subjektit të mbikeqyrjes inspektuese dhe

2) vëllimit të pasojave të demshme, që del nga përfshirja e shfrytëzuesve të prodhimit përkatësisht shërbimit që jepet nga ana e subjektit të mbikeqyrjes inspektuese.

(8) Probabiliteti i ndodhjes së pasojave të demshme vlerësohet në baza të:

1) punës paraprake dhe veprimit të subjektit të mbikeqyrjes inspektuese, duke e përfshirë edhe gjendjen e përcaktuar të fundit të ligjshmerisë dhe sigurisë në punën dhe veprimin e tij;

2) standardeve dhe dokumenteve tjera të standardizuara që e përbejnë standardizimin nacional, si dhe rregullat e praktikës së mirë që i zbaton subjekti i mbikeqyrjes inspektuese;

3) sistemeve për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e brendshme të punës së subjektit të mbikeqyrjes inspektuese;

4) gjendjes në sferën në të cilën behet veprimtaria dhe parashikimet për lëvizjet e ardhshme në atë sferë dhe

5) kapaciteteve të brendshme dhe të jashtme profesionale, teknike, teknologjike dhe financiare të subjektit të mbikeqyrjes inspektuese.

(9) Elementet e vlerësimit të rrezikut, si dhe shpeshësia e zbatimit të mbikeqyrjes inspektuese në baza të vlerësimit të rrezikut, me akt i përcakton Këshilli.

Neni 3

3

Plani vjetor për punën e shërbimit mbikeqyres

(1) Planin vjetor për punën e shërbimit inspektues nga neni 26 i këtij ligji, e miraton drejtori përkatësisht udhëheqësi i shërbimit inspektues, me të voni deri në fundin e vitit rrjedhës, për vitin e ardhshëm, i cili publikohet në faqen e internetit të shërbimit inspektues.

(2) Planin vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni, për punën e shërbimit inspektues nga neni 26, paragrafi (1), pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, me të voni deri më 15 nëntor dergohet të Këshilli, në formë elektronike dhe në formë me letër.

(3) Këshilli i jep pëlqim me shkrim Planit vjetor nga paragrafi (2) i këtij neni, me të voni deri më 15 dhjetor.

(4) Formën dhe përmbajtjen e Planit vjetor nga paragrafi (1) të këtij neni, e përcakton Këshilli.

Neni 3

4

Plani mujor per mbikeqyrje inspektuese

(1) Ne baze te planit vjetor per punen e sherbimit inspektues, drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues nga neni 26 i ketij ligji, me se voni deri ne fillim te muajit, miraton plan mujor per punen e cdo inspektori.

(2) Gjate perpilimit te planit mujor nga paragrafi (1) i ketij neni, drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues duhet ta marre parasysh edhe mungesen eventuale te inspektorit per shkak te shfrytezimit te pushimit vjetor, persosjes profesionale dhe trajnimit ose shkaqe tjera te arsyeshme.

(3) Plani mujor per punen nga paragrafi (1) i ketij neni, per sherbimet inspektuese nga neni 26, paragrafi (1), pikat 1 dhe 2 te ketij ligji, ne afat prej 10 ditesh nga dita e miratimit, dergohet te Keshilli, per informim, ne forme elektronike.

(4) Formen dhe permbajtjen e planit mujor nga paragrafi (1) te ketij neni, i percakton Keshilli.

Neni 3

5

Raporti per punen e sherbimit inspektues

(1) Raportin per punen e sherbimit inspektues per gjashte muajt paraprake, e miraton drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues nga neni 26 i ketij ligji, me se voni deri me 15 korrik per periudhen janar – qershor ne vitin rrjedhes, perkatesisht me se voni deri me 15 janar per periudhen korrik – dhjetor te vitit paraprak, i cili publikohet ne faqen e internetit te sherbimit inspektues.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i ketij neni, per punen e sherbimeve inspektuese nga neni 26, paragrafi (1), pikat 1 dhe 2 te ketij ligji, me se voni deri me 31 korrik perkatesisht 31 janar dergohet te Keshilli, ne forme elektronike dhe ne forme me leter.

(3) Keshilli jep mendim per Raportin nga paragrafi (2) i ketij neni, me se voni deri me 31 gusht perkatesisht 28 shkurt. Mendimi permban konstatime, udhezime dhe rekomandime per permiresimin e punes se sherbimit inspektues.

(4) Nese mendimi nga paragrafi (3) i ketij neni eshte negativ, Keshilli, do te parashtroje propozim per shkarkimin e drejtorit ne Qeveri, perkatesisht propozim per ngritjen e procedures disiplinore per shkelje disiplinore, kunder udheheqesit te sherbimit inspektues, te personi udheheqes i organit ne perberjen e te cilit eshte formuar sherbimi inspektues.

(5) Me se voni deri me 31 mars ne vitin rrjedhes, ne baze te raporteve gjashtemujore nga paragrafi (2) i ketij neni, Keshilli dergon per informim ne Qeveri, raport vjetor per punen e sherbimeve inspektuese, i cili publikohet ne faqen e internetit te Keshillit.

(6) Formen dhe permbajtjen e raporteve nga paragrafet (1) dhe (5) te ketij neni, i percakton Keshilli.

Neni 3

6

Regjistrat dhe sistemi informativ per mbikeqyrje inspektuese

Formen dhe permbajtjen e regjistrave si dhe menyren e vendosjes, shfrytezimit dhe permbajtjen e sistemit informativ per mbikeqyrjen inspektuese nga neni 18, pika 18) te ketij ligji i percakton Keshilli.

Neni 3

7

Evidenca inspektuese

(1) Sherbimet inspektuese per kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese, detyrimisht mbajne evidence te vecante per te dhenat qe kane te bejne me proceduren inspektuese.

(2) Formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes se evidences inspektuese nga paragrafi (1) i ketij neni, e percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

VI. Statusi dhe punesimi i inspektorit

Neni 3

8

Kategorite dhe nivelet e vendeve te punes per inspektore

Vendet e punes te inspektoreve klasifikohen ne kategorite B dhe V dhe nivelet perkatese, sic eshte percaktuar me Ligjin per nepunes administrative.

Neni 3

9

Titujt e inspektoreve

Nivelet ne kornizat e kategorive, per inspektoret ne menyre plotesuese pershkruhen me tituj, si vijon:

- 1) B1 – inspektor i pergjithshem;
- 2) B2 – kryeinspektor;
- 3) B3 – ndihmes kryeinspektor;

- 4) B4 – inspektor i larte;
- 5) V1 – keshilltar inspektor;
- 6) V2 – inspektor i pavarur;
- 7) V3 – ndihmes inspektor dhe
- 8) V4 – inspektor i ri.

Neni 4 **0**

Kushti i vecante per punesimin e inspektorit

(1) Kandidati per inspektor nga kategoria B, krahas kushteve te pergjithshme per punesim te percaktuara ne Ligjin per nepunes administrative, duhet t'i permbush kushtet e vecanta si vijon:

1) kualifikimet profesionale per te gjitha nivelet nga kategoria B – niveli i kualifikimit VIA sipas Kornizes Maqedonase te Kualifikimeve dhe se paku 240 kredi te fituara sipas SETK-se ose shkallen VII/1 te mbaruar;

2) pervoje pune, si vijon:

- B1 – se paku gjashte vjet pervoje pune pas diplomimit, prej te cilave se paku dy vjet si inspektor,

- B2 – se paku pese vjet pervoje pune pas diplomimit, prej te cilave se paku dy vjet si inspektor dhe

- B3 dhe B4 – se paku kater vjet pervoje pune pas diplomimit, prej te cilave se paku nje vjet si inspektor;

3) kompetencat e pergjithshme te punes per te gjitha nivelet ne pajtim me Kornizen e kompetencave te pergjithshme te punes;

4) kompetencat e vecanta te punes per te gjitha nivelet:

- njohja aktive e njerës nga te tri gjuhet me shpesh te shfrytezuara te Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht);

- njohje aktive e programeve kompjuterike per pune ne zyre.

(2) Kandidati per inspektor nga kategoria V, krahas kushteve te pergjithshme per punesim te percaktuara ne Ligjin per nepunes administrative, duhet t'i permbush kushtet e vecanta si vijojne:

1) kualifikimet profesionale edhe ate:

- per nivelin V1 – niveli i kualifikimit VIA sipas Kornizes Maqedonase te Kualifikimeve dhe se paku 240 kredi te fituara sipas SETK-se ose te mbaruar shkallen VII/1 dhe

- per nivelet V2, V3 dhe V4 – niveli i kualifikimit VIB sipas Kornizes Maqedonase te Kualifikimeve dhe se paku 180 kredi te fituara sipas SETK-se ose te mbaruar shkallen VII/1 dhe

2) pervojen e punes, si vijon:

- V1 – se paku tri vjet perwoje pune pas displomimit,
 - V2 – se paku dy vjet perwoje pune pas displomimit,
 - V3 – se paku nje vit perwoje pune pas displomimit,
 - V4 – me dhe pa perwoje pune pas diplomimit,
- 3) kompetencat e pergjithshme te punes per te gjitha nivelet ne pajtim me Kornizen e kompetencave te pergjithshme te punes;
- 4) kompetencat e vecanta te punes per te gjitha nivelet:
- njohje aktive e njerës nga te tri gjuhët me shpesh te shfrytezuara te Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht);
 - njohje aktive e programeve kompjuterike per punen ne zyre.

Neni
41

Plotesimi i vendit te punes per inspektor

- (1) Vendi i lire i punes per inspektor plotesohet nepermjet procedurave si vijon:
- 1) punesimit;
 - 2) avancimit ne vend te punes ne nivel me te larte per llojin e njejte te inspektorit;
 - 3) marrjes se inspektorit nga njeri sherbim ne sherbimin tjeter inspektues, ne vendin e punes ne kategorie dhe nivelin e njejte;
 - 4) marrjes se nepunesit administrativ ne sherbimin inspektues, ne vendin e punes ne kategorie dhe nivelin e njejte dhe
 - 5) sistematizimit te inspektorit ne sherbimin e njejte inspektues ne vendin tjeter te punes ne nivel te njejte per llojin e njejte te inspektorit.
- (2) Procedurat per plotesimin e vendit te lire te punes nga paragrafi (1) i ketij neni, zbatohen ne pajtim me Ligjin per nepunesit administrative dhe Ligjin per te punesuarit ne sektorin publik.

VII. Licenca per inspektor

Neni 4
2

Trajnimi per marrjen e licences per inspektor

(1) Trajnimi per marrjen e licences per inspektor zbatohet ne baze te programit per trajnim dhe perbehet prej dy pjeseve ne kohezgjatje te pergjithshme prej 12 muajve, edhe ate:

1) tre muaj trajnim interaktiv dhe

2) nente muaj pune praktike dhe trajnim te vendit te punes, nen mbikeqyrjen e mentorit ne sherbimin inspektues ku eshte i punesuar.

(2) Mentori caktohet nga radhet e inspektoreve udheheqes ne sherbimin inspektues, e nese nuk ka te tille, atehere inspektori nga niveli V1, me se paku pese vjet pervoje si inspektor.

(3) Kandidati per inspektor i zgjedhur nepermjet procedures per punesim dhe kandidati per inspektor i punesuar nepermjet procedures per marrjen e nepunesit administrativ, ndjek trajnim per marrjen e licences per inspektor nga paragrafi (1), pikat 1 dhe 2 te ketij neni.

(4) Kandidati per inspektor i punesuar nepermjet procedures per marrjen e inspektorit nga njeri sherbim ne sherbimin tjeter inspektues, ndjek trajnim per marrjen e licences per inspektor nga paragrafi (1), pika 2 te ketij neni.

(5) Programin per trajnim nga paragrafi (1), pika 1, te ketij neni e miraton Keshilli.

(6) Programin per punen praktike dhe trajnimin e vendit te punes nga paragrafi (1), pika 2, te ketij neni, e miraton drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues.

(7) Formen dhe permbajtjen e programeve per trajnim nga paragrafi (1) i ketij neni, e percakton Keshilli.

Neni 4

3

Provimi per marrjen e licences per inspektor

(1) Provimi per marrjen e licences per inspektor, perbehet nga pjesa e pergjithshme dhe pjesa praktike.

(2) Pjesen e pergjithshme te provimit nga paragrafi (1) i ketij neni, e organizon dhe e zbaton Keshilli.

(3) Pjesen praktike te provimit nga paragrafi (1) i ketij neni, e organizon dhe e zbaton sherbimi inspektues ku eshte i punesuar kandidati per inspektor.

(4) Pjesa e pergjithshme e provimit nga paragrafi (1) i ketij neni, jepet sipas Programit per provim per licence - pjesa e pergjithshme, te cilen e miraton Keshilli.

(5) Pjesa praktike e provimit nga paragrafi (1) i ketij neni, jepet sipas Programi per provim per licence – pjesa praktike, qe e miraton drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues.

(6) Programet per provim nga paragrafet (4) dhe (5) te ketij neni, baza e pyetjeve per provim, si dhe literatura relevante, jane te arritshme publikisht ne faqen e internetit te Keshillit.

(7) Kandidati per inspektor i zgjedhur nepermjet procedures per punesim dhe kandidati per inspektor i punesuar nepermjet procedures per marrjen e nepunesit administrativ, pas skadimit te periudhes per trajnim nga neni 42, paragrafi (1), jep provim per marrjen e licences per inspektor, ne sesionin e pare te caktuar te provimit.

(8) Kandidati per inspektor i zgjedhur nepermjet procedures per marrjen e inspektorit nga njeri sherbim ne sherbimin tjeter inspektues, pas skadimit te periudhes per trajnim nga neni 42, paragrafi (1), pika 2 te ketij ligji, jep provim per marrjen e licences per inspektor, ne sesionin e pare te caktuar te provimit.

(9) Kandidati per inspektor nga paragrafi (7) dhe paragrafi (8) i ketij neni, i cili nuk e ka dhene provimin per licence per inspektor, ka te drejte ta jap ate edhe nje here, ne sesionin e pare te ardhshem te provimit.

(10) Kandidatit per inspektor nga paragrafi (7) dhe paragrafi (8) te ketij neni, te cilit edhe gjate provimit te serishem nuk e jep provimin per licence per inspektor, i nderpritet punesimi ne sherbimin inspektues.

(11) Menyren per zbatimin e provimit nga paragrafi (1) i ketij neni, e percakton Keshilli.

Neni 4

4

Leshimi dhe vlefshmeria e licences per inspektor

(1) Licencen per inspektor ne sherbimet inspektuese nga neni 26, paragrafi (1) te ketij ligji, e leshon Keshilli, pas pjeses se pergjithshme te dhene paraprakisht te provimit nga neni 43, paragrafi (4) te ketij ligji dhe marrjes se njoftimit me shkrim nga sherbimi inspektues per pjesen e dhene praktike te provimit nga neni 43, paragrafi (5) te ketij ligji.

(2) Personi udheheqes i sherbimit inspektues e dergon njoftimin me shkrim nga paragrafi (1) i ketij neni, ne afat prej pese ditesh nga dita e dhenies se provimit.

(3) Licenca nga paragrafi (1) i ketij neni, ka vlefshmeri te perhershme.

(4) Formen dhe permbajtjen e formularit per licence per inspektor, e percakton Keshilli.

Neni 4

5

Heqja e licences per inspektor

(1) Drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues e njofton Keshillin ne afat prej 7 (shtate) ditesh nga ditet e perfundimit te aktvendimit per nderprerjen e punesimit te inspektorit kur kane ndodhur pasoja te demshme per institucionin, me c'rast nuk jane konstatuar rrethana lehetuese per inspektorin i cili e ka kryer shkeljen ose sipas fuqise se ligjit.

(2) Pas marrjes se njoftimit nga paragrafi 1 i ketij neni, Keshilli miraton vendim per heqje te licences per inspektor.

Neni 4

6

Legjitimacioni zyrtar dhe distinktivi

(1) Inspektori ka legjitimacion zyrtar dhe distinktiv, me të cilin e deshmon cilesine, identitetin dhe autorizimet e tij.

(2) Pas marrjes se licences per inspektor, drejtori perkatesisht personi udheheqes i organit perkatesisht kryetari i komunes, ne kuader te te cileve eshte sherbimi inspektues, i leshon inspektorit zyrtar legjitimacion dhe distinktiv nga paragrafi (1) i ketij neni.

(3) Ne rast te nderprerjes se marredhenies se punes ose supervizionit ne pajtim me ligjin, inspektori eshte i detyruar qe me ditën e miratimit te aktvendimit per nderprerje te marredhenies se punes, perkatesisht aktvendim per suspension t'ia ktheje legjitimacionin zyrtar dhe distinktivin, drejtorit perkatesisht personit udheheqes te organit perkatesisht kryetarit te komunes, i cili e ka leshuar.

(4) Formen dhe permbajtjen e formularit te legjitimacionit zyrtar dhe distinktit te inspektorit, si dhe menyren e leshimit te tyre dhe heqjen ne sherbimet inspektuese nga neni 26, paragrafi (1) i ketij ligji, i percakton Keshilli.

VIII. Te drejtat dhe obligimet e inspektorit

Neni 4

7

Dispozita e pergjithshme

(1) Per ceshtjet qe kane te bejne me te drejtat dhe obligimet e marredhenies se punes te inspektoreve, te cilat nuk jane rregulluar me kete ligj dhe per ceshtjet per te cilat ky ligj nuk sugjeron ne zbatimin e ligjit tjeter, zbatohen dispozitat e Ligjit per te punesuarit ne sektorin publik.

Neni 4

8

Rroga, kompensime dhe shtesa te rroges se inspektorit

(1) Inspektori ka te drejte te rroges dhe kompensimeve te rroges nen kushte dhe kriteret te percaktuara ne Ligjin per nepunes administrative, pervec nese nuk eshte percaktuar ndryshe me kete ligj.

(2) Inspektori ka te drejte te shteses se rroges per shkak te ekzistimit te rrezikut te larte per jete dhe shendetin gjate kryerjes se puneve dhe detyrave te inspektorit ne lartesi prej 30% te shumes se rroges baze.

Neni 4

9

Persosja profesionale dhe trajnimi i inspektoreve

(1) Inspektori ka te drejte dhe detyrim qe ne menyre te vazhdueshme dhe profesionale te persoset dhe trajnohet, ne pajtim me nevojat e sherbimit inspektues ne te cilin eshte punesuar.

(2) Persosja profesionale nga paragrafi (1) i ketij neni, realizohet permes trajnimeve gjenerike dhe te specializuara.

(3) Keshilli perkatesisht kryetari i komunes, me se voni deri me 30 qershor ne vitin rrjedhes, miraton Program vjetor per trajnime gjenerike te inspektoreve per vitin e ardhshem.

(4) Mjetet per realizimin e programit nga paragrafi (3) i ketij neni, sigurohen nga Buxheti i Republikes se Maqedonise se Veriut perkatesisht buxheti i njesive te veteqeverisjes lokale.

(5) Per realizimin e programit nga paragrafi (3) i ketij neni, Keshilli vendos njesi te brendshme organizative, per mbeshtetjen te trajnimit te inspektoreve nga sherbimet inspektuese, nga neni 26 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 e ketij ligji.

(6) Trajnimet e specializuara per inspektore dhe mjetet per realizimin e tyre, i siguron sherbimi inspektues.

Neni 5

0

Plani vjetor individual per persosje profesionale dhe trajnim te inspektorit

(1) Ne baze te Programit vjetor nga neni 49 paragrafi (3) i ketij ligji, drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues, me se voni deri me 30 nentor ne vitin rrjedhes, miraton Plan vjetor per persosje profesionale individuale dhe trajnim te cdo inspektori ne vitin e ardhshem.

(2) Ne planin vjetor nga paragrafi (1) i ketij neni, jane perfshire se paku tri trajnime te pergjithshme te Programit vjetor nga neni 49, paragrafi (3) i ketij ligji.

Neni 5

1

Shperblimi per inspektor

(1) Inspektorit mund t'i ndahet shperblim ne lartesi prej nje rroge te tij njehere gjate vitit kalendarik.

(2) Kriteret per ndarje te shperblimit nga paragrafi (1) i ketij neni jane:

1) angazhimi i vecante ne kryerjen e punes,

2) cilesia ne kryerjen e punes,

3) kontributi i konsiderueshem ne realizimin e funksionit te sherbimit inspektues dhe

4) perqindja per realizimin e programit vjetor per mbikeqyrje.

(3) Shperblimi nga paragrafi (1) i ketij neni e perjashton kompensimin per suksesin ne punen per nepunes administrative, ne pajtim me Ligjin per nepunes administrative.

(4) Per shperblimin ne para nga paragrafi (1) i ketij neni, vendos drejtori perkatesisht personi udheheqes i organit perkatesisht kryetari i komunes, me propozim te udheheqesit epror te drejtperdrejte.

(5) Keshilli miraton udhezim per ndarje te shperblimit ne para nga paragrafi (1) i ketij neni.

Neni 5

2

Sigurimi nga fatkeqesia gjate punes

Sherbimi inspektues ne llogari te vet, detyrimisht e siguron inspektorin per raste te fatkeqesise gjate punes.

Neni 5

3

Obligimi per ruajtje te sekretit

Inspektori eshte i detyruar qe gjate kohezgjatjes dhe pas nderprerjes se punesimit, t'i ruaje ne fshehtesi te gjitha te dhenat qe i ka kuptuar gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, te cilat me rregull ose me akt te pergjithshme te subjektit te mbikeqyrjes inspektuese, jane percaktuar si sekret afarist.

Neni 5

4

Obligimi per mbrojtje te te dhenave personale

Inspektori eshte i detyruar qe gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese t'i zbatoje rregullat per mbrojtje te te dhenave personale.

Neni 5

5

Pergjegjesia e inspektorit

(1) Përveç përgjegjësisë për shkelje disiplinore në pajtim me Ligjin për nepunë administrative, inspektori është përgjegjës në mënyrë disiplinore edhe nëse gjatë kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese:

1) nuk i ndermerr masat adekuate të cilat në pajtim me këtë ose ligj tjetër ka qenë i detyruar t'i ndermarre;

2) nuk i njofton organet kompetente për kundërvajtje të ligjeve ose rregullave tjera të cilat me procesverbal i ka konstatuar gjatë kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese;

3) nuk vepron në pajtim me obligimin për ruajtje të sekretit afarist nga neni 53 i këtij ligji dhe

4) nuk vepron në pajtim me obligimin për zbatimin e rregullave për mbrojtje të të dhënave personale nga neni 54 i këtij ligji.

(2) Kunder aktvendimit për përgjegjësi disiplinore, të miratuar nga drejtori perkatesisht udhëheqësi i shërbimit inspektues, inspektori ka të drejtë të ankesës në afat prej të tete ditësh nga dita e të tete, në Agjencinë e Administratës.

IX. Kontributi i inspektorit

Neni 5

6

Menaxhimi me kontributin e inspektorit

(1) Për menaxhim me kontributin e inspektorit, vendoset një sistem qëllimi i të cilit është avancimi i rezultatit institucional përmes avancimit të rezultatit individual dhe identifikimit të mangësive dhe potencialeve për zhvillimin e inspektorit.

(2) Sistemi për menaxhim me kontributin nga paragrafi (1) i këtij neni, përbehet nga: plani për mbikeqyrje inspektuese, qëllime tjera të punës dhe detyra nga neni 58 paragrafi (1) i këtij ligji dhe plani vjetor individual për personë profesionale dhe trajnim të inspektorit.

Neni 5

7

Vlerësimi i kontributit të inspektorit

(1) Inspektorët gjatë punës së tyre, në bazë të ndjekjes së vazhdueshme të kontributit të tyre, çdo vit vlerësohet me se voni deri më 31 janar në vitin rrjedhës, për vitin paraprak, në pajtim me këtë ligj.

(2) Inspektorët të cilët gjatë vitit kanë munguar në punë më gjatë se gjashtë muaj (pushim mjekësor, pushim pa pagesë dhe ngjashëm, por jo edhe pushim vjetor), si dhe kandidatët për inspektor të cilët për herë të parë janë punësuar në shërbimin inspektues dhe nuk posedojnë licencë për inspektor, nuk do të vlerësohen.

(3) Vleresimin e kontributit te inspektoreve e kryen drejtperdrejt udheheqesi epror i drejtperdrejte.

(4) Vleresimi i kontributit te inspektoreve behet ne baze te te dhenave qe kane te bejne me rezultatet nga puna e tyre dhe kualitetet personale qe i kane treguar gjate punes.

(5) Rezultatet nga puna e inspektorit dhe cilesite personale, vleresohen ne baze te kritereve per sukses te inspektorit nga neni 59 i ketij ligji.

(6) Me se voni tete dite pas vleresimit te realizuar, drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues miraton aktvendim per note vjetore te inspektorit.

(7) Kunder aktvendimit nga paragrafi (6) i ketij neni, inspektori ka te drejte te ankeses ne afat prej tete ditesh nga dita e pranimit te aktvendimit, ne Agjencine e administrates.

(8) Menyren e vleresimit dhe formen dhe permbajtjen e formularit per vleresim te kontributit te inspektoreve, i percakton Keshilli.

Neni 5

8

Qellime dhe detyra tjera te punes se inspektorit

(1) Qellimet dhe detyrat tjera te punes se inspektorit, percaktohen ne pershkrimin e vendit te punes ne aktin per sistematizim te vendeve te punes te sherbimit inspektues edhe ne pajtim me planin strategjik dhe/ose planit vjetor per pune.

(2) Qellimet dhe detyrat tjera te punes duhet te jene te qarte, precize dhe te matchme, me kornizen e percaktuar kohore per realizim.

(3) Detyrat e punes te inspektoreve udheheqes (kategoria B), detyrimisht perfshijne kryeje te mbikeqyrjes inspektuese si vijon:

- 1) inspektore me nivel B1 – se paku 10% te orarit mujor te punes;
- 2) inspektore me nivel B2 – se paku 15% te orarit mujor te punes;
- 3) inspektore me nivel B3 – se paku 25% te orarit mujor te punes;
- 4) inspektore me nivel B4 – se paku 35% te orarit mujor te punes;

Neni 5

9

Kritere per sukses

(1) Kritere per sukses te inspektoreve jane te dhenat dhe informatat per shkallen e realizimit te:

- 1) planit mujor per mbikeqyrje inspektuese nga neni 34 te ketij ligji;
- 2) qellimeve dhe detyrave tjera nga neni 58 paragrafi (1) i ketij ligji dhe

3) planit vjetor individual per persosje profesionale dhe trajnim te inspektorit nga neni 50 i ketij ligji.

(2) Kriteri nga paragrafi (1), pika 1) e ketij neni, vleresohet ne menyren ne vijim:

1) raporti ndermjet numrit te pergjithshem te mbikeqyrjeve te planifikuara inspektuese te percaktuara ne planet mujore per punen e cdo inspektori dhe numrin e pergjithshem te mbikeqyrjeve inspektuese te paraqitura ne raportet gjashtemujore per pune, si vijon:

- mbi 95% realizimi i mbikeqyrjeve te planifikuara inspektuese – 30 pike;
- 75-95% realizimi i mbikeqyrjeve te planifikuara inspektuese – 20 pike;
- 50-75% realizimi i mbikeqyrjeve te planifikuara inspektuese – 10 pike;
- me pak se 50% realizim te mbikeqyrjeve te planifikuara inspektuese – 0 pike;

2) Respektimi i afateve ligjore per perгатitje te procesverbaleve dhe miratimi i akteve inspektuese edhe ate:

- respektimi i afateve ne mbi 95% te mbikeqyrjeve - 20 pike,
- respektimi i afateve ne 75-95% te mbikeqyrjeve inspektuese - 15 pike,
- respektimi i afateve ne mbi 50-75% te mbikeqyrjeve - 10 pike,
- respektimi i afateve ne me pak se 50% te mbikeqyrjeve inspektuese - 0 pike,

3) Mbajtja e procesverbaleve dhe aktvendimeve ne format me leter dhe/ose elektronik, rregullsi ne udheheqjen e lendeve qe jane ne pune te inspektori dhe cilesia e shprehjes me shkrim te inspektorit dhe ate:

- cilesia e shkelqyeshme – 15 pike,
- cilesia e mire – 10 pike dhe
- cilesia e keqe – 0 pike.

(3) Kriteri nga paragrafi (1), pika 2 e ketij neni, vleresohet ne menyren ne vijim:

- 1) mbi 95% realizim te qellimeve dhe detyrave tjera te punes – 20 pike;
- 2) 75-95% realizim te qellimeve dhe detyrave tjera te punes – 15 pike;
- 3) 50-75% realizim te qellimeve dhe detyrave tjera te punes – 10 pike;
- 4) me pak se 50% realizim te qellimeve dhe detyrave tjera te punes – 0 pike;

(4) Kriteri nga paragrafi (1), pika 3 e ketij neni, vleresohet ne menyren ne vijim:

1) mbi 95% realizim te planit vjetor individual per persosje profesionale dhe trajnim te inspektorit – 15 pike;

2) 75-95% realizim te planit vjetor individual per persosje profesionale dhe trajnim te inspektorit – 10 pike;

3) 50-75% realizim te planit vjetor individual per persosje profesionale dhe trajnim te inspektorit – 5 pike;

4) me pak se 50% realizim te planit vjetor individual per persosje profesionale dhe trajnim te inspektorit – 0 pike.

(5) Suksesi i inspektorit perlogaritet si permbledhje e pikeve te realizuara ne paragrafet (2), (3) dhe (4) te ketij neni, me c'rast vlera maksimale mund te jete 100 pike.

Neni 6
0

Vleresimi per kontribut te inspektorit

(1) Vleresimi per kontribut te inspektorit shprehet me pershkrim si rezultat i pikeve te realizuara per sukses per periudhe prej nje viti dhe mund te jete:

- 1) "A – vecanerisht dallohet", prej 96 – 100 pike;
- 2) "B – dallohet", prej 76 – 95 pike;
- 3) "V – mjaftueshem", 56 – 75 pike;
- 4) "G – pjeserisht mjaftueshem", prej 36 – 55 dhe
- 5) "D – pamjaftueshem", 0 – 35 pike.

Neni 6
1

Raport per vleresim te kontributit te inspektorit

(1) Ne baze te notave individuale inspektoret ne sherbimin inspekional, drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues perpilon Raport per vleresim.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i ketij neni, paraqet analize cilesore dhe kuantitative te procesit te vleresimit te inspektoreve.

(3) Raporti nga paragrafi (1) i ketij neni, per vleresimin ne sherbimet inspektuese nga neni 26, paragrafi (1), pikat 1 dhe 2 te ketij ligji, i dergohet Keshillit me se voni deri me 15 mars te vitit rrjedhes, per informim.

(4) Formen dhe permbajtjen e Raportit nga paragrafi (1) te ketij neni, i percakton Keshilli.

X. Te drejta dhe obligime te subjektit te mbikeqyrjes inspektuese gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese

Neni 6
2

E drejta e subjektit te mbikeqyrjes inspektuese

Subjekti i mbikeqyrjes inspektuese perkatesisht
personi i caktuar nga ana e tij, ka te drejte:

- 1) te propozoje dhe te parashtroje deshmi te cilat jane te rendesishme per konstatimin e gjendjes faktike, gjate procedures per kryerje te mbikeqyrjes inspektuese;
- 2) ta refuzoje ta nenshkruaje procesverbalin nese nuk pajtohet me faktet te cilat jane paraqitur ne procesverbalin apo nese nuk i eshte mundesuar e drejta te jape verejtje per te njejtin;
- 3) te jape verejtje me arsyetim, per procesverbalin per mbikeqyrje te kryer inspektuese, ne lidhje me:
 - ligjshmerine e procedures se mbikeqyrjes inspektuese,
 - sjelljen e inspektorit dhe
 - saktesine e gjendjes se konstatuar faktike;
- 4) njoftim me shkrim per lenden dhe kohezgjatjen e mbikeqyrjes se rregullt inspektuese, te shoqeruar me liste te kontrollit;
- 5) te jete i informuar me te drejtat dhe obligimet qe i ka ne kontekst te mbikeqyrjes inspektuese;
- 6) te jete i njoftuar me bazen juridike per kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese;
- 7) ta paralajmeroje inspektorin per fshehtesine e informatave qe ia jep ne dispozicion;
- 8) ta shoqeroje inspektorin/et gjate kohes se mbikeqyrjes inspektuese qe kryhet ne hapesirat e subjektit;
- 9) te marre ekzemplar te seciles liste per kontrollim qe do te perdoret gjate mbikeqyrjes inspektuese.

Neni 6

3

Obligimi i subjektit te mbikeqyrjes inspektuese

- (1) Subjekti i mbikeqyrjes inspektuese eshte i obliguar qe inspektorit t'i mundesoje qasje ne hapesirat, produktet, bazat elektronike te te dhenave ose cfare do mjeti tjeter qe eshte lende e mbikeqyrjes inspektuese, si dhe keqyrje ne dokumentacionin e pergjithshem dhe informatat e domosdoshme per konstatimin e gjendjes faktike.
- (2) Subjekti i mbikeqyrjes inspektuese eshte i obliguar me kerkese me shkrim te inspektorit, ne afatin e percaktuar me kerkesen, inspektorit t'i dergoje ose per ate te pergatit te dhena, raporte, materiale ose dokumente tjera te sakta dhe te plota qe jane te domosdoshme per kryerje te mbikeqyrjes inspektuese.
- (3) Subjekti i mbikeqyrjes inspektuese eshte i obliguar inspektorit t'i siguroje kushtet e domosdoshme per zbatimin e mbikeqyrjes inspektuese.
- (4) Subjekti i mbikeqyrjes inspektuese eshte i obliguar te caktoj person qe do te jete i pranishem gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese.

(5) Subjekti i mbikeqyrjes inspektuese eshte i obliguar pas kerkeses se inspektorit te arsyetuar me shkrim, ta nderpret punen gjate kohes se mbikeqyrjes inspektuese, nese inspektori ne menyre tjeter nuk mund ta kryeje mbikeqyrjen inspektuese.

(6) Subjekti i mbikeqyrjes inspektuese eshte i obliguar menjehere pas skadimit te afatit te caktuar per kryerjen e mases inspektuese, kurse me se voni ne afat prej tri diteve, me shkrim dhe/ose me poste elektronike, ta informoje inspektorin nese eshte zbatuar masa inspektuese.

XI. Menyra dhe procedura e kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese

Neni 6

4

Qellimi i mbikeqyrjes inspektuese

Qellimi i mbikeqyrjes inspektuese eshte veprim parandalues ose ndermarrje e masave per parandalim ose menjanim te pasojave mbi te mirat e mbrojtura, te drejtat ose interesat si dhe shqiptim te masave inspektuese per menjanimin e parregullsive dhe mangesive te konstatuara.

Neni 6

5

Koeficientet e kompleksitetit te mbikeqyrjes inspektuese

(1) Drejtori perkatesisht personi udheheqes i sherbimit inspektues, percakton pese koeficiente te kompleksitetit te mbikeqyrjes inspektuese.

(2) Koeficientet e kompleksitetit te mbikeqyrjes inspektuese, percaktohen ne baze te kriterëve ne vijim:

1) kushtet ne te cilat behet mbikeqyrja inspektuese dhe ekspozimi i inspektorit ndaj ndikimeve te mundshme mbi shendetin dhe jeten e vet;

2) numer i subjekteve qe jane lende e mbikeqyrjes inspektuese;

3) numer i dispozitave ne baze te te cilave behet mbikeqyrja inspektuese;

4) koha e nevojshme per kryerje te mbikeqyrjes inspektuese.

(3) Sipas nivelit, inspektori mund te kryeje mbikeqyrje inspektuese me koeficient te nderlikueshmerise, si ne vijim:

1) Inspektori me nivel B1 dhe B2 – koeficienti i nderlikueshmerise Q5;

2) Inspektori me nivel B3, B4 dhe V1 – koeficienti i nderlikueshmerise Q4 dhe Q5;

3) Inspektori me nivel V2 – koeficienti i nderlikueshmerise Q3 dhe Q4;

4) Inspektori me nivel V3 – koeficienti i nderlikueshmerise Q2 dhe Q3;

5) Inspektori me nivel V4 – koeficienti i nderlikueshmerise Q1 dhe Q2.

(4) Me perjashtim, per shkak te realizimit me efikas te mbikeqyrjes inspektuese, inspektori mund te kryej mbikeqyrje inspektuese edhe me koeficient me te ulet te nderlikueshmerise te percaktuar ne paragrafin (3) te ketij neni.

Neni 6

6

Menyra dhe procedura e realizimit te mbikeqyrjes inspektuese

(1) Mbikeqyrja inspektuese realizohet ne pajtim me planin mujor per punen e cdo inspektori ose me urdher me shkrim te drejtorit ose personit udheheqes te organit perkatesisht kryetarit te komunes, ne perberje te te cilit gjendet sherbimi inspektues si dhe me urdher te leshuar nga Keshilli.

(2) Procedura e kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese perbehet prej kater fazave edhe ate: planifikimi, realizimi, mbyllja dhe dokumentimi i mbikeqyrjes inspektuese.

(3) Per shkak te vellimit ose nderlikueshmerise, mbikeqyrje inspektuese mund te kryejne me shume inspektore.

(4) Gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese nga me shume inspektore nga sherbimi inspektues, perpilohet nje procesverbal dhe miratohet nje akt inspektues, qe nenshkruhet nga te gjithë inspektoret qe kane marre pjese ne mbikeqyrjen inspektuese.

(5) Gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, nuk guxon te cenohet sekreti i te dhenave personale.

(6) Menyren e realizimit te mbikeqyrjes inspektuese, me propozim te Keshillit, me udhezim e percakton Qeveria.

Neni 6

7

Legjitimimi i inspektorit

Para fillimit te kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, inspektori eshte i detyruar qe subjektit te mbikeqyrjes inspektuese t'ia prezantoje legjitimacionin e vet zyrtar dhe distinktiv.

Neni 6

8

Llojet e mbikeqyrjes inspektuese

Mbikeqyrja inspektuese mund te jete e rregullt, e jashtezakonshme dhe kontrolluese.

Neni 6

9

Mbikeqyrja e rregullt inspektuese

(1) Mbikeqyrja e rregullt inspektuese eshte mbikeqyrje inspektuese mbi zbatimin e ligjeve dhe rregullave perkatese te miratuara ne baze te atyre ligjeve dhe behet sipas nje programi paraprakisht te parashikuar ne planin vjetor nga neni 33 i ketij ligji dhe planin mujor nga neni 34 i ketij ligji.

(2) Mbikeqyrja e rregullt inspektuese njoftohet me dorezimin e njoftimit me shkrim subjektivit te mbikeqyrjes inspektuese per kohen dhe vellimin e mbikeqyrjes inspektuese.

(3) Njoftimi nga paragrafi (2) i ketij neni, shoqeruar me listen per kontroll nga neni 69 te ketij ligji, dorezohet me se voni tri dite pune para fillimit te kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese.

(4) Me perjashtim te paragrafit (2) te ketij neni, mbikeqyrja e rregullt inspektuese nuk do te njoftohet kur ekzistojne shkaqe per veprim te paprolongushem ose shqetesim te arsyeshem se njoftimi do ta pengoje ose zvogeloje realizimin e qellimit te mbikeqyrjes inspektuese ose kur per ate ekziston interes publik per realizimin e rrezikut per jeten dhe shendetin e njerezve dhe mjedisit jetesor.

(5) Ne rastet nga paragrafi (4) i ketij neni, inspektori eshte i detyruar qe shkaqet t'i fuse ne procesverbalin per mbikeqyrjen inspektuese.

(6) Me kerkese te inspektorit, subjekti i mbikeqyrjes inspektuese pergatit dhe dorezon raport per veteveprimin per permbushjen e kerkeseve te cekura ne listen per kontroll neni 70 i ketij ligji, shoqeruar me dokumente perkatese me te cilat deshmohej autenticiteti i konstatimeve ne raportin.

(7) Mbikeqyrja e rregullt inspektuese nga sherbimi inspektues te subjekti i njejte i mbikeqyrjes inspektuese behet jo me shume se njehere ne vit, pervec nese me ligj tjeter nuk eshte percaktuar ndryshe.

Neni 7

0

Lista per kontroll

(1) Lista per kontroll eshte dokument i cili permban pyetje per kontroll dhe veprime tjera per te cilat eshte autorizuar sherbimi inspektues, te percaktuara sipas peshes se pasojave te mundshme te demshme ne sferen e caktuar ne pajtim me lenden dhe vellimin e kontrollit.

(2) Sherbimi inspektues miraton lista per kontroll per sferen perkatese te kompetencave, qe publikohen ne ueb faqet e sherbimit inspektues.

(3) Pyetjet per kontroll dhe veprime tjera te cekura ne listen per kontroll nga paragrafi (1) i ketij jane te detyrueshme gjate mbikeqyrjes se rregullt inspektuese.

(4) Sherbimi inspektues e kryen azhurnimin e listes per kontroll nga paragrafi (1) i ketij nenise paku nje here ne vit, e sipas nevojës edhe me shume.

Neni 7

1

Mbikeqyrja e jashtezakonshme inspektuese

(1) Mbikeqyrja e jashtezakonshme inspektuese kryhet me detyre zyrtare ose ne baze te iniciatives se parashtruar nga persona fizike dhe juridike, organe te pushtetit shteteror ose lokal, si dhe me urdher te Keshillit ose urdher me shkrim te ministrit, drejtorit ose personit udheheqes te organit, perkatesisht kryetarit te komunes ne perberje te te cilit gjendet sherbimi inspektues.

(2) Mbikeqyrja e jashtezakonshme inspektuese sipas rregulles eshte mbikeqyrje e paparalajmeruar inspektuese dhe ajo realizohet menjehere e me se voni ne afat prej dhjete dite pune nga pranimi i iniciatives ose urdhrit ose urdhereses me shkrim, nga paragrafi (1) i ketij neni, ne sekretarine e sherbimit inspektues ose ne adresen elektronike zyrtare te sherbimit inspektues, nese ekziston i tille.

Neni 7

2

Iniciativa per mbikeqyrje inspektuese

(1) Iniciativa per mbikeqyrje inspektuese duhet te permbaje: emertimin e sherbimit inspektues te i cili paraqitet, emrin dhe mbiemrin dhe adresen e jeteses se parashtruesit perkatesisht emertimi dhe selia e personit juridik, perfaqesuesi ligjor ose i autorizuari nese e ka, pershkrim i shkurter i cenumit dhe caktimi i subjektit te i cili kerkohet kryera e mbikeqyrjes inspektuese.

(2) Inspektori nuk do te veproje sipas iniciatives per mbikeqyrje inspektuese, ne rast kur i njehti eshte i paplote ose e paqarte dhe per ate e njofton parashtruesin, me se voni ne afat prej 15 ditesh nga dita e pranimi te iniciatives.

(3) Inspektori nuk do te veproje me initiative anonime per mbikeqyrje inspektuese, pervec nese permbajtja e iniciatives nuk ngre ceshtje te interesit publik te percaktuar me ligj ose eshte i nevojshem menjanimi i rrezikut te drejtperdrejte per jeten ose shendetin e njerezve ose prones me vlere me te madhe ose mjedisin jetesor.

(4) Ne rast kur iniciativa per mbikeqyrje inspektuese nuk eshte ne kompetence te sherbimit inspektues, inspektori ne afat prej tri ditesh pune nga dita e marrjes, te njehten ia paraqet sherbimit inspektues per procedure te metutjeshme dhe per te njehten e njofton parashtruesin e iniciatives.

(5) Me se voni ne afat prej 15 ditesh pas perfundimit te mbikeqyrjes se jashtezakonshme inspektuese ne baze te iniciatives se parashtruar, inspektori eshte i detyruar qe ta njoftoje parashtruesin per rezultatin nga mbikeqyrja inspektuese.

Neni 7

3

Urdherese per kryerje te mbikeqyrjes se jashtezakonshme inspektuese individuale

(1) Kryetari i Keshillit i leshon urdherese per kryerje te mbikeqyrjes se jashtezakonshme individuale mbi punen e subjektit te caktuar te mbikeqyrjes inspektuese, drejtorit perkatesisht udheheqesit te sherbimit inspektues nga neni 26 paragrafi (1), pika 1 dhe 2 e ketij ligji.

(2) Urdheresa nga paragrafi (1) i ketij neni, leshohet, ne rastet vijuese:

1) me kerkese te Qeverise perkatesisht organit tjeter shteteror perkatesisht komunes, komunes ne Qytetin e Shkupit dhe Qytetit te Shkupit;

2) me kerkese te personit fizik dhe juridik, nese ne procedure paraprake per iniciativen e parashtruar ne sherbimin inspektues, nuk eshte parashtruar dhe per ate nuk ka arsyetim adekuat;

3) me sherbim zyrtar ose me propozim te anetarit kompetent te Keshillit, per shkak te:

- mbrojtjes se interesit publik te percaktuar me ligj,

- menjanimit te rrezikut te drejtperdrejte per jeten ose shendetin e njerezve ose prones me vlere me te madhe ose mjedisin jetesor,

- nderlikueshmeria e mbikeqyrjes inspektuese ose rendesia per menjanimin e mangesive.

(3) Urdheresa nga paragrafi (1) i ketij neni, leshohet ne afat prej tri ditesh pune, nga pranimi i kerkeses perkatesisht nga kuptimi per shkeljen e interesit publik.

(4) Drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues, eshte i detyruar qe ne afat prej tri ditesh pune nga marrja e urdhereses nga paragrafi (1) i ketij neni, ta organizoje dhe realizoje mbikeqyrjen e jashtezakonshme inspektuese.

(5) Me se voni ne afat prej pese ditesh pune pas perfundimit te mbikeqyrjes inspektuese, drejtori perkatesisht udheheqesi i sherbimit inspektues, eshte i detyruar qe ne Keshill te dorezoje raport per mbikeqyrjen e realizuar inspektuese.

Neni 7

4

Urdherese per kryerjen e mbikeqyrjes se perbashket te jashtezakonshme inspektuese

(1) Kryetari i Keshillit leshon urdherese per kryerjen e mbikeqyrjes se perbashket te jashtezakonshme inspektuese mbi punen e nje subjekti te caktuar per mbikeqyrjen inspektuese, drejtoreshve ose drejtuesve te sherbimeve inspektuese nga neni 26 paragrafi (1), pika 1 dhe 2 te ketij ligji.

(2) Urdheresa nga paragrafi (1) i ketij neni, leshohet, ne rastet ne vijim:

1) me kerkese te Qeverise perkatesisht organit tjeter shteteror perkatesisht komunes, komunes ne Qytetin e Shkupit dhe Qytetit te Shkupit;

2) me propozim te drejtorit ose udheheqesit te sherbimit inspektues nga neni 26 paragrafi (1), pika 1 dhe 2 te ketij ligji;

3) me kerkese te personit fizik ose juridik, nese ne proceduren paraprake pas parashtrimit te ankesses ne sherbimin inspektues, nuk eshte vepruar dhe nuk ka shpjegim adekuat per kete;

4) me detyre zyrtare ose me propozim te nje anetari kompetent te Keshillit, per shkak te:

- mbrojtjes se interesit publik te percaktuar me ligj,
- heqjen e rrezikut te menjehershme te jetes ose shendetit te njerezve ose prones me vlere me te madhe ose mjedisit jetesor,
- nderlikueshmeria e mbikeqyrjes inspektuese ose rendesia per menjanimin te mangesive.

(3) Urdheresa nga paragrafi (1) i ketij neni leshohet ne afat prej tri dite pune nga marrja e kerkeses, respektivisht propozimit gjegjesisht zbulimi i shkeljes se interesit publik ose rrezikut te drejtperdrejte.

(4) Urdheresa nga paragrafi (1) i ketij neni, permban: emertimin e sherbimit inspektues - koordinatori, listen e sherbimeve te inspektimit per kryerjen e inspektimit te perbashket te jashtem, emrin ose emertimin e subjektit te mbikeqyrjes inspektuese dhe perfshirjen e mbikeqyrjes se perbashket inspektuese te jashtezakonshme.

(5) Koordinatorin nga paragrafi (4) i ketij neni eshte i detyruar, ne afat prej pese ditesh pune nga marrja e urdhereses nga paragrafi (1) i ketij neni, te organizoje dhe te zbatoje mbikeqyrjen e perbashket inspektuese te jashtezakonshme.

(6) Me se voni ne afat prej dhjete diteve pas mbarimit te mbikeqyrjes inspektuese, koordinatori nga paragrafi (4) i ketij neni, eshte i obliguar t'i paraqese Keshillit raport per mbikeqyrjen e perbashket inspektuese te jashtezakonshme.

Neni 7

5

Pergjegjesia per moszbatimin e urdhereses per mbikeqyrje inspektuese

Nese drejtori ose udheheqesi i sherbimit inspektues nga neni 26 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) te ketij ligji nuk vepron sipas urdhrimit nga nenet 73 dhe 74 te ketij ligji, pa arsye te justifikuar, Keshilli, me iniciative te kryetarit ose anetarit te Keshillit do te paraqese propozim ne Qeveri per shkarkimin e drejtorit, perkatesisht propozim per ngritjen e procedures disiplinore per shkelje disiplinore, kunder udheheqesit te sherbimit inspektues, tek personi udheheqes i organit ne te cilen perberje eshte formuar sherbimi i inspektimit.

Neni 7

6

Mbikëqyrja kontrolluese inspektuese

(1) Mbikëqyrja inspektuese kontrolluese eshte mbikeqyrje inspektuese e kryer me detyre zyrtare me qellim qe inspektori te percaktojë nese subjekti i mbikeqyrjes inspektuese, pas skadimit te afatit te percaktuar ne aktin e inspektimit, me mbikeqyrjen e kryer te rregullt ose te jashtezakonshme inspektuese:

- 1) ka vepruar sipas aktit inspektues ne tersi;
- 2) ka vepruar pjeserisht sipas aktit inspektues dhe
- 3) nuk ka vepruar pas aktit inspektues.

(2) Mosveprimi perkatesisht veprimi i pjesshem pas aktit inspektues paraqet baze per zbatimin e mases inspektuese ne perputhje me ligjin.

Neni 7

7

Mbikeqyrja e perbashket inspektuese

(1) Mbikeqyrja e perbashket inspektuese eshte mbikeqyrje inspektuese e rregullt ose e jashtezakonshme, ku marrin pjese dy ose me shume sherbime inspektuese.

(2) Gjate kryerjes se mbikeqyrjes se perbashket inspektuese, sherbimet e inspektimit jane te detyruar te bashkepunojne ndermjet veti permes konsultimeve dhe harmonizimit.

Neni 7

8

Shpenzimet e mbikeqyrjes inspektuese

(1) Shpenzimet per kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese percaktohen sipas shpenzimeve reale te kryera per mbikeqyrjen e kryer inspektuese, shpenzimet per kryerjen e matjeve te nev ojshe dhe analizave laboratorike dhe shpenzimeve te transportit.

(2) Shpenzimet nga paragrafi (1) te ketij neni per proceduren e kryer pa shqiptuar mase inspektuese, i mbart sherbimi inspektues qe ka kryer mbikeqyrjen inspektuese.

(3) Shpenzimet nga paragrafi (1) i ketij neni, per procedure qe eshte kryer me shqiptimin e mases inspektuese, pervec verejtjes i mbart subjekti i mbikeqyrjes inspektuese.

(4) Lartesine e shpenzimeve nga paragrafi (1) i ketij neni e percakton drejtori ose personi udheheqes i organit respektivisht kryetari i komunes.

Neni 7

9

E drejta e inspektorit gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese

(1) Inspektori ka te drejte te kryeje mbikeqyrjen inspektuese mbi subjektet e mbikeqyrjes inspektuese, ne cdo kohe dhe ne vend, ne hapesirat afariste, instalimet dhe objektet e tjera qe nuk perdoren si vendbanim, si dhe mbi mjetet dhe pajisjet per kryerjen e veprimtarise dhe / ose aktivitetit per te cilen me akt adekuat, te leshuar nga organi adekuat i administrates shteterore, rregullohet kryerja e veprimtarise.

(2) Inspektori gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, ka te drejte:

1) per qasje atje ku e konsideron te nevojshme dhe ne cdo kohe, ne hapesirat dhe hapesirat afariste, lokacione dhe mjetet e transportit dhe te drejten per te kontrolluar ne menyre te panderprere tere dokumentacionin e nevojshem te subjektit te mbikeqyrjes inspektuese;

2) ne qasje ne proceset teknologjike, prodhuese dhe proceseve te tjera qe jane pjese e veprimtarive dhe / ose aktiviteteteve te subjektit te mbikeqyrjes inspektuese;

3) vulosjen e hapesirave dhe / ose lendeve brenda nje periudhe kohore te nevojshme per sigurimin e provave te nevojshme per kryerjen e procedures kundervajtese ose penale;

4) te kryeje mbikeqyrje ne dokumentin per identifikimin e personave te autorizuar nga subjekti i mbikeqyrjes inspektuese, punonjesve te tjere ose personave te angazhuar ne punen ne subjektin e mbikeqyrjes inspektuese, si dhe personave fizike qe gjenden ne vendin e mbikeqyrjes inspektuese;

5) ta fotografoje dhe incizojë hapesiren ne te cilen kryhet mbikeqyrja inspektuese, si dhe lendet qe jane lende e mbikeqyrjes inspektuese;

6) te shqiptoje per subjektin dhe mbikeqyrjes inspektuese paralajmerim ose nje mase tjeter inspektimi dhe afat per menjanimin e parregullsive dhe defekteve te identifikuar ne perputhje me kete ligj ose ligj tjeter;

7) ta mbikeqyre zbatimin e masave te inspektimit per heqjen e parregullsive dhe mangesive, ne afatin qe eshte percaktuar;

8) te paraqese kerkese per ngritjen e procedures kundervajtjes dhe / ose penale kunder subjektit te mbikeqyrjes inspektuese, tek organi kompetent, i cili eshte i detyruar ta njoftoje inspektorin per vendimin e tij.

(3) Inspektori ka te drejte dhe obligim ta paralajmerojë ose ta largojë personin qe e pengon kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese.

(4) Ne rastin kur gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, inspektori percakton shkelje te ligjit ose rregulloreje tjeter ose nje akti qe eshte ne kompetence te nje sherbimi tjeter inspektues, percakton vete gjendjen faktike dhe pergatit raport per konstatimet e tij, qe i dorezon ne sherbimin e inspektimit kompetent.

Neni 8

0

Bashkepunimi me organet kompetente dhe institucionet tjera

(1) Inspektori ka te drejte qe gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese te kerkoje te dhena nga organi shteteror ose personi juridik qe mban regjister dhe ato jane te detyruar te bashkepunojne me inspektorin.

(2) Inspektori ka te drejte gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese te kerkoje pranine e personit zyrtar te autorizuar nga organi i administrates shteterore kompetent per punet e brendshme, i cili eshte i detyruar te marre pjese ne zbatimin e mbikeqyrjes inspektuese.

(3) Inspektori ka te drejte qe gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese te kerkoje pranine e personit zyrtar nga organi profesional, njesia organizative e duhur e komunes, komuna ne Qytetin e Shkupit respektivisht Qyteti i Shkupit, institucionet e tjera profesionale dhe personat

juridike, nese per percaktimin e fakteve ose rrethanave te rendesishme nevojitet nje mendim i tille profesionist.

Neni 8

1

Mbikeqyrje inspektuese te subjekti i panjohur

(1) Ne rast se subjekti i mbikeqyrjes se inspektimit nuk mund te vertetohet, inspektori ne vendin e mbikeqyrjes inspektuese do te lere ftese me shkrim per subjekt te panjohur per mbikeqyrjen inspektuese, ne te cilen percakton koha e pranise per kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese.

(2) Demtimi i mevonshem, shkaterrimi ose heqja e ftese me shkrim nga paragrafi (1) i ketij neni, nuk ndikon ne rregullsine e lenies se fteses me shkrim.

Neni 8

2

Procesverbal

i

(1) Per mbikeqyrjen e kryer inspektuese, gjendjen faktike te percaktuar, parregullsite dhe mangesite e konstatuara dhe te vertetuara, verejtjet, deklaratat dhe faktet dhe rrethanat tjera relevante, inspektori duhet te pergatise procesverbal me shkrim ne vendin e kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese.

(2) Procesverbalin nga paragrafi (1) i ketij neni e nenshkruajne inspektori dhe subjekti i mbikeqyrjes inspektuese, te cilit i dorezohet nje ekzemplar. Nese subjekti i mbikeqyrjes inspektuese refuzon ta nenshkruaje procesverbalin, inspektori duhet t'i theksoje arsyet per refuzimin.

(3) Me perjashtim te paragrafit (1) i ketij neni, kur per shkak te vellimit dhe kompleksitetit te mbikeqyrjes inspektuese, natyres se tij dhe rrethanave te punes, nuk eshte e mundur te perpilohet procesverbal ne vendin e kryerjes se mbikeqyrjes, procesverbal i perpilohet ne hapesirat zyrtare te sherbimit inspektues ne afat prej tre ditesh nga dita e mbikeqyrjes inspektuese, me arsyetim te shkaqeve per te.

(4) Ekzemplari nga procesverbal i paragrafi (3) i ketij neni i dorezohet per nenshkrim subjektit te mbikeqyrjes inspektuese. Nese, ne afat prej tete diteve nga dita e pranimi, subjekti i mbikeqyrjes se inspektimit nuk shprehet ne lidhje me procesverbalin e paraqitur ose nuk e kthen ate te nenshkruar, konsiderohet se pajtohet me permbajtjen e tij.

(5) Formen dhe permbajtjen e procesverbalit per mbikeqyrjen inspektuese te kryer ne Keshill, i percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

Neni 8

3

Verejtja dhe aktvendimi

(1) Gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese, inspektori me aktvendim shqipton paralajmerim dhe cakton afat ne te cilin subjekti i mbikeqyrjes inspektuese eshte i detyruar te eliminoje parregullsitet dhe mangesite e percaktuara me procesverbal.

(2) Me perjashtim te paragrafit (1) te ketij neni, ne rastin kur inspektori konstaton se parregullsitet e percaktuara dhe mangesite mund te shkaktojne ose rrezik te drejtperdrejte per jeten dhe shendetin e njerezve ose dem financiar apo dem te prones me vlere me te larte apo rrezikim te mjedisit jetesor ose rrezikimin e interesit publik, me vendim shqipton mase tjeter inspektuese si borxh, urdher, ndalese dhe mase tjeter, nese eshte percaktuar me ligj te vecante, me te cilen ne menyre me te pershtatshme do te arrihet qellimi i mbikeqyrjes inspektuese.

(3) Nese, pas skadimit te afatit te percaktuar gjate shqiptimit te verejtjes nga paragrafi (1) i ketij neni, inspektori percakton se ende nuk jane hequr parregullsitet dhe mangesite, me vendim shqipton nje mase tjeter inspektuese, si detyrimim, urdher, ndalim dhe mase tjeter, nese percaktohet me ligj te vecante, me te cilen ne menyre me adekuate do te arrihet qellimi i mbikeqyrjes inspektuese.

(4) Aktvendimi nga paragrafet (1), (2) dhe (3) te ketij neni, miratohet menjehere dhe me se voni tete dite nga dita e pergatitjes se procesverbalit nga neni 82 i ketij ligji.

(5) Kur gjate mbikeqyrjes inspektuese nuk jane percaktuar parregullsitet dhe shkeljet tjera te ligjit ose rregulle tjeter ose parregullsitet e percaktuara jane menjanuar gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese ose ne afatin e percaktuar ne vendimin nga paragrafi (1) i ketij neni, inspektori e ndalon proceduren me konstatim ne procesverbal nga neni 82 i ketij ligji.

(6) Me perjashtim te paragrafeve (2) dhe (3) te ketij neni, inspektori mund te shqiptoje mase inspektuese me vendim me goje te theksuar ne procesverbalin nga neni 82 te ketij ligji.

(7) Ne rastin nga paragrafi (6) i ketij neni, inspektori eshte i detyruar menjehere dhe me se voni ne afatin e percaktuar ne paragrafin (4) te ketij neni, te miratoje aktvendim me shkrim per shqiptimin e mases.

(8) Formen dhe permbajtjen e aktvendimit nga paragrafet (1), (2) dhe (3) te ketij neni me propozim te Keshillit, i percakton Ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

Neni 8

4

Mjeti juridik

Kunder aktvendimit te inspektorit nga neni 83 i ketij ligji, mund te paraqitet ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e miratimit te vendimit, tek organi kompetent per vendimmarrje ne shkalle te dyte.

Neni 8

5

Publikimi i akteve inspektuese

Aktet e inspektimit publikohen ne ueb faqen e sherbimit te inspektimit, me se voni pese dite nga dita e miratimit te akteve dhe ne perputhje me rregullat per mbrojtjen e te dhenave personale.

XII. Veprimet e vecanta ne proceduren inspektuese

Neni 8

6

Marrja e ekzemplarit

Nese ne proceduren e mbikeqyrjes inspektuese nevojitet te percaktohet nese prodhimet ne prodhim ose ne shitje korrespondojne me perberjen e percaktuar, perkatesisht cilesine, inspektori mund te marre ekzemplare, ne perputhje me ligjin.

Neni 8

7

Procedura per marrjen e ekzemplarit

Gjate marrjes se ekzemplarit inspektori eshte i obliguar:

- 1) ne te njejtat kushte dhe ne te njejten kohe te marre me se shumti tre ekzemplare ne sasine e nevojshme per analize (per analizen e pare, per analizen e dyte me kerkese te subjektit te mbikeqyrjes inspektuese dhe per super analize);
- 2) te perpiloje procesverbal per marrjen e ekzemplarit;
- 3) ekzemplaret t'i vulos dhe t'i shenoje ne menyre te rregullt;
- 4) ta dergoje pa prolongim ekzemplar in per analizen e pare ne nje institucion te akredituar per ekspertize, ndersa ekzemplar in e dyte dhe te trete t'i ruaje ne kushte te pershtatshme;
- 5) ta njoftoje me shkrim dhe pa prolongim subjektin e mbikeqyrjes inspektuese per rezultatet e analizet;
- 6) ta dergoje pa vonese ekzemplar in e dyte te analizes ne nje institucion tjeter te akredituar me kerkese te subjektit te mbikeqyrjes inspektuese dhe

7) te percaktoje me konkluzione te posacme shumen e shpenzimeve te shkaktuara gjate procedures ne lidhje me analizen e ekzemplareve, ne rast se ekzemplari nuk korrespondon me standardet e pershkruara.

Neni 8

8

Supozimi per pelqim

Nese subjekti i mbikeqyrjes inspektuese gjate marrjes se ekzemplarit per analize nuk kerkon njekohesisht marrjen e ekzemplarit per analizen e dyte, nuk mund te kontestojte rezultatet e analizes se marre.

Neni 8

9

Kontestimi i rezultateve te analizes

(1) Subjekti i mbikeqyrjes inspektuese mund te kontestojte rezultatet e analizes se ekzemplarit se pare me kerkese per kryerjen e analizes se ekzemplarit se dyte (te marre ne te njejten kohe dhe ne te njejten menyre), ne afat prej tri diteve nga dita e dorezimit te rezultateve te analizes se ekzemplarit te pare.

(2) Nese subjekti i mbikeqyrjes inspektuese nga paragrafi (1) i ketij neni nuk e dorezon afatin e caktuar, konsiderohet se pajtohet me rezultatet e analizes se ekzemplarit te pare.

(3) Analiza e ekzemplarit te dyte nuk mund t'i besohet institucionit te akredituar qe ka kryer analizen e ekzemplarit te pare.

(4) Nese rezultatet e analizes se ekzemplarit te dyte nuk perputhen me rezultatet e analizes se ekzemplarit te pare, inspektori ne afat prej tri diteve nga marrja e ketyre rezultateve eshte i detyruar te paraqese kerkese per kryerjen e super-analizes.

(5) Super-analiza nga paragrafi (4) i ketij neni nuk mund te kryhet nga institucion i akredituar qe ka kryer analizat e meparshme dhe nese nuk ka institucione te tjera per kryerjen e ketyre analizave ne vend, analiza mund t'i besohet institucionit nga shtetet anetare te Bashkimit Evropian.

Neni 9

0

Shpenzimet e analizes

(1) Shpenzimet e analizes i bart subjekti i mbikeqyrjes inspektuese, nese percaktohet se ekzemplaret e marre nuk korrespondojne me standardet e pershkruara.

(2) Shpenzimet e analizes mbulohen nga sherbimi inspektues kompetent, nese percaktohet se ekzemplaret jane ne perputhje me standardet e pershkruara.

Neni 9

1

Marrja e perkohshme e lendeve per shkak te sigurimit te deshmive

(1) Inspektori mundet ne suaza te kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese te marre perkohesisht dokumente, mall dhe sende tjera qe mund te sherbejne si deshmi ne proceduren perkatese.

(2) Marrja e sendeve nga paragrafi (1) i ketij neni zgjat deri ne miratimin vendimit te plotfuqishem ne procedure.

Neni 9

2

Marrja e detyrueshme e lendeve

Inspektori eshte i detyruar te marre perkohesisht lende, kur marrja e tyre e detyrueshem eshte percaktuar, kur me ta eshte kryer shkelje ose veper penale ose nese eshte e nevojshme per te parandaluar pasojat me te renda, ne perputhje me ligjin.

Neni 9

3

Leshimi i detyrueshem i vertetimit per marrjen e perkohshme te lendeve dhe shkresave

(1) Inspektori i jep vertetim subjektit te mbikeqyrjes inspektuese, prej te cilit perkohesisht merren lendet dhe shkresat.

(2) Vertetimi nga paragrafi (1) i ketij neni permban te dhena per emrin dhe mbiemrin, perkatesisht emertimin e subjektit te mbikeqyrjes inspektuese, kohen dhe vendin e marrjes se lendeve dhe shkresave, perberjen ligjore per marrjen e lendeve dhe shkresave, emertimi i sakte i lendeve te marra dhe shkresave sipas llojit, sasise, nenshkrimit te personit pergjegjes te subjektit te mbikeqyrjes inspektuese dhe te dhena te tjera te nevojshme per identifikimin e lendeve te marra dhe shkresave dhe nenshkrimin, emrin dhe mbiemrin e inspektorit.

Neni 9

4

Obligimi per dorezimin e lendeve te marra

(1) Lendet ose mallrat e marra, inspektori ia dorezon Agjencise per Menaxhim me Pronen e Konfiskuar te Republikes se Maqedonise se Veriut.

(2) Kerkesa per ngritjen e procedures kundervajtese ne lidhje me paragrafin (1) te ketij neni i paraqitet gjykates kompetente ose organit per kundervajtje pas zbatimit te procedures per barazim.

(3) Organi kompetent gjyqesor, kundervajtes dhe organi tjeter eshte i obliguar ne rastet nga paragrafi (1) i ketij neni, te vendose me procedure urgjente.

Neni 9

5

Sigurimi i kushteve per marrjen e perkohshme te lendeve

Sherbimi inspektues eshte i detyruar te siguroje kushtet per ruajtjen e lendeve te marra perkohesisht ose te mallrave te gjalla deri ne transferimin e tyre ne Agjencine per Menaxhim me Pronen e Konfiskuar te Republikes se Maqedonise se Veriut, nese me ligj nuk eshte percaktuar ndryshe.

Neni 9

6

Ndalim i perkohshem per kryerjen e veprimtarise

(1) Kur organi inspektues percakton parregullsi dhe mangesi qe rrezikojne jeten ose shendetin e njerezve ose te mjedisit jetesor dhe ne raste te tjera te percaktuara me ligj, inspektori ndalon perkohesisht kryerjen e veprimtarise se subjektit te mbikeqyrjes duke vulosur hapesirat, objektet, vendet e ndertimit, pajisjet, mjetet e punes dhe mjetet tjera, derisa te eliminohen parregullsitet dhe mangesite.

(2) Subjekti i mbikeqyrjes inspektuese nuk duhet te heqe shenjen e vules nga paragrafi (1) i ketij neni, para kohes se percaktuar nga inspektori.

XIII. Marredheniet e sherbimeve inspektuese dhe organeve kompetente

Neni 9

7

Procedura urgjente

(1) Procedura per kerketat dhe kallezimet e inspektoreve eshte urgjente.

(2) Organi kompetent eshte i obliguar menjehere, ndersa me se voni ne afat prej tete diteve nga dita e parashtrimit t'i merr ne shqyrtim kerketat dhe kallezimet e inspektoreve, nese nuk eshte percaktuar afat me i shkurter me kete ligj ose ligj tjetet.

(3) Organi tek i cili eshte parashtruar kallezimi penal, kerkese per ngritje te procedures per kundervajtje ose kerkese per ngritje te procedures tjeter perkatese eshte i obliguar per rezultatet e procedures ta informoje sherbimin kompetent inspektues.

XIV. Dispozita kundervajtese

Neni 9

8

Gjoba per subjekte te mbikeqyrjes inspektuese

(1) Inspektori i shqipton gjobe ne shume prej 1.500 euro ne kundervlere me denare per kundervajtje, personit juridik, nese:

1) inspektorit nuk i mundeson qasje ne hapësirat, produktet ose çfare do mjeti tjetet qe eshte lende e mbikeqyrjes inspektuese, si dhe keqyrje ne dokumentacionin e pergjithshem dhe informatat e domosdoshme per konstatimin e gjendjes faktike, qe jane lende e mbikeqyrjes inspektuese (neni 63, paragrafi (1));

2) inspektorit nuk i dergon ose pergatit te dhena, raporte, materiale ose dokumente tjera te sakta dhe te plota te cilat jane te domosdoshme per kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese (neni 63, paragrafi (2));

3) nuk e nderpren punen gjate mbikeqyrjes inspektuese (neni 63, paragrafi (5));

4) nuk i lejon inspektorit te marre ekzemplar (neni 86);

5) nuk i lejon inspektorit perkohesisht te konfiskoje dokumente, mallra dhe lende tjera te cilat mund te sherbejne si deshmi ne proceduren perkatese (neni 91, paragrafi (1) dhe neni 92).

(2) Inspektori shqipton gjobe ne shume prej 450 euro ne kundervlere me denarin per kundervajtjet nga paragrafi (1) i ketij neni edhe personit pergjegjes ne personin juridik.

(3) Inspektori i shqipton gjobe ne shume prej 250 euro ne kundervlere me denarin per kundervajtjet nga paragrafi (1) i ketij neni personit fizik.

(4) Inspektori i shqipton gjobe ne shume prej 750 euro ne kundervlere me denarin per kundervajtje personit juridik, nese:

1) inspektorit nuk ia siguron kushtet e domosdoshme per zbatimin e mbikeqyrjes inspektuese (neni 63, paragrafi (3));

2) nuk cakton person i cili do te jete i pranishem gjate kryerjes se mbikeqyrjes inspektuese (neni 63, paragrafi (4));

3) e largon shenjen per mbylljen e hapësirave, objekteve, vendeve te ndertimit, pergatitjes, mjeteve per pune dhe mjeteve tjera, para kohes se percaktuar nga inspektori (neni 96, paragrafi (2)).

(5) Inspektori i shqipton gjobe ne shume prej 250 euro ne kundervlere me denarin per kundervajtjet nga paragrafi (4) i ketij neni edhe personit pergjegjes ne personin juridik.

(6) Inspektori i shqipton gjobe ne shume prej 150 euro ne kundervlere me denarin per kundervajtjet nga paragrafi (4) i ketij neni personit fizik.

Neni 9

9

Gjoba per drejtorin respektivisht per udheheqesin e sherbimit inspektues

(1) Gjobe ne shume prej 450 eurosh ne kundervlere me denare do t'i shqiptohet drejtorit respektivisht udheheqesit te sherbimit inspektues nga neni 26 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) te ketij ligji, nese:

- nuk e publikon ne ueb faqe te keshillit inspektues raportin e punes per gjashte muajt paraprake me se voni deri me 15 korrik per periudhen janar-qershor ne vitin rrjedhes, respektivisht me se voni deri me 15 janar per periudhen korrik-dhjetor ne vitin paraprak (neni 35 paragrafi (1)) dhe

- nese nuk e dorezon raportin e punes per gjashte muajt paraprake me se voni deri me 15 korrik per periudhen janar-qershor ne vitin rrjedhes, respektivisht me se voni deri me 15 janar per periudhen korrik-dhjetor ne ne Keshill, ne leter dhe ne forme elektronike (neni 35 paragrafi (2)).

(2) Gjoben per kundervajtjet nga paragrafi (1) i ketij neni e shqipton Inspektorati administrative Shteteror.

Neni 10

0

Barazim

i

Per kundervajtjet nga neni 98 te ketij ligji, para parashtrimi te kerkeses per ngritje te procedures per kundervajtje prane gjykates kompetente, inspektori eshte i obliguar kryeresit te kundervajtjes t'i propozoje procedure per kompensim ne pajtim me Ligjin per kundervajtje.

Neni 10

1

Zbatimi i Ligjit dhe mbikeqyrja

(1) Mbikeqyrje ne zbatimin e ketij ligji ben organi i administrates kompetent per punet e administrates shteterore.

(2) Mbikeqyrje inspektuese ne zbatimin e ketij ligji, si dhe te dispozitave te miratuara ne baze te te njejtit, ben Inspektorati Shteteror Administrativ.

XVI.Dispozita kalimtare dhe perfundimtare

Neni 10

2

Zbatimi i Ligjit per procedura te filluara

Procedurat inspektuese te filluara para dites se fillimit te zbatimit te ketij ligji, do te perfundojne sipas dispozitave ne fuqi para dites se fillimit te zbatimit te ketij ligji.

Procedurat per punesim dhe avancim te inspektoreve te filluara para dites se fillimit te zbatimit te ketij ligji, do te perfundojne sipas Ligjit per mbikeqyrje inspektuese ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 50/10, 162/10, 157/11, 147/13, 41/14, 33/15, 193/15, 53/16, 11/18, 83/18 dhe 120/18).

Neni 10

3

Vlefshmeria e licencave per inspektor

(1) Licencat per inspektor te leshuara para dites se fillimit te aplikimit te ketij ligji vlejne deri ne skadimin e afatit per te cilin jane leshuar.

(2) Tre muaj para skadimit te vlefshmerise se licences nga paragrafi (1) i ketij neni, Keshilli, me kerkese te bartesit te licences, do te leshoje licence te re per inspektor me vlefshmeri permanente.

(3) Inspektori i cili posedon licence te perkohshme te leshuar para dites se fillimit me zbatimin e ketij ligji, do te marre licence per inspektor ne pajtim me Ligjin per mbikeqyrjes inspektuese ("Gazeta Zyrtare e Republikes se Maqedonise" numer 50/10, 162/10, 157/11, 147/13, 41/14, 33/15, 193/15, 53/16, 11/18, 83/18 dhe 120/18).

(4) Per personat te cilet kane marre licence per inspektor sipas dispozitave qe kane qene ne fuqi prej dites se fillimit te zbatimit te ketij ligji, kurse nuk jane inspektore, nuk do te aplikohen dispozitat nga nenet 42 dhe 43 te ketij ligji.

(5) Keshilli ne afat prej tre muajve nga dita e fillimit me aplikimin e ketij ligji, do t'i leshoje licence per inspektor ne fushen perkatese, inspektorit te punesuar ne sherbimet inspektuese nga neni 26, paragrafi (1), pika 3 e ketij ligji.

Neni 10

4

Shtesa e rroges te inspektorit

(1) Dispozita nga neni 48, paragrafi (2) i ketij ligji do te filloje te aplikohet ne etapa prej 1 janarit 2020, kurse zbatimi i plote do te realizohet deri me 1 janar 2022.

(2) Shtesa e rroges per inspektor do te rritet ne etapa ne pajtim me paragrafin (1) te ketij neni, ne menyren si vijon:

- 1) 10% nga 1 janari 2020;
- 2) 10% nga 1 janari 2021 dhe
- 3) 10% nga 1 janari 2022.

Neni 105

Keshilli inspektues

(1) Keshilli me ditën e fillimit të zbatimit të ketij ligji, vazhdon të punojë në pajtim me kompetencat e percaktuara në këtë ligj.

(2) Kryetari dhe anëtarët e Keshillit të emëruar para ditës së fillimit me zbatimin e ketij ligji, vazhdojnë të kryejnë funksionin e vet deri në ditën e skadimit të mandatit të tyre, me të drejta, obligime dhe autorizime të percaktuara me këtë ligj.

Neni 10

6

Harmonizimi i ligjeve

Ligjet me të cilat është rregulluar kompetenca e sherbimeve inspektuese, do të harmonizohen me dispozitat e ketij ligji në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 10

7

Harmonizimi i akteve per organizim te brendshem dhe te akteve per sistematizim te vendeve te punes

Keshilli dhe sherbimet inspektuese do t'i harmonizojne aktet per organizim te brendshem dhe aktet per sistematizimin e vendeve te punes ne afat prej gjashte muajve nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Neni 10

8

Miratimi i akteve nenligjore

Aktet nenligjore te parapara me kete ligj do te miratohen ne afat prej gjashte muajve nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Neni 10

9

Shfuqizim i

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për mbikeqyrje inspektuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 50/10, 162/10, 157/11, 147/13, 41/14, 33/15, 193/15, 53/16, 11/18, 83/18 dhe 120/18).

Neni 11

0

Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi ne ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë se Veriut", kurse do të fillojë të zbatohet gjashtë muaj nga dita e hyrjes së tij në fuqi.